

**CALL YOUR COUNTRY**  
 FOL ME VENDIN TËND  
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.  
**WIND**  
 Informacione në wind.it



E PËRMUAJSHME/MENSILE VITI/ANNO VI NR.7 - LUGLIO/AGOSTO 2009 - € 1,50

# shqiptari i italisë

*l'albanese d'italia*


**CALL YOUR COUNTRY**  
 FOL ME VENDIN TËND  
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.  
**WIND**  
 Informacione në wind.it

BOTA SHQIPTARE - Il Mondo Albanese Edizioni - Redazione Viale Marco Polo 119, 00154 Roma - Tel 06.57289240 Fax 06.62209543

# fluturimi i BERNARDIT

Quket Bernard Shehu një ndër balerinët e skenave galante që nuk ndriçohen nga prozhektorët e studiove televizive, por që nuk e nderojnë më pak baletin shqiptar. Madje e ngrajnë edhe më lart.

Pas një rrugëtimi të gjatë që prej vitit 2000, sot jeton në Romë dhe është pjesë e kompanisë Balletto di Roma së bashku me të tjerë balerinë shqiptarë që me të ndajnë të njëjtën kombësi e të njëjtën histori jete.



Shqiptarët  
në Itali  
janë

**441  
MIJË**

Madje 441.073. Të dhënat vjetore të radhës të sapopublikuara nga ISTAT tregojnë se shqiptarët rezidentë me dokumente të rregullta përbëjnë një komunitet të ngulitur tashmë në territorin italian, grupi i parë mes të huajve jo komunitarë



**WESTERN UNION**  
**MONEY TRANSFER**

Vodafone One Nation SMS

**Mund të merrni lajme çdo ditë nga vendi juaj**

Merrni lajme për vendin tuaj dhe informacione për jetën tuaj në Itali. Dërgoni një SMS me tekst ALBANIA në 42246. Java e parë është falas.

Shërbimi kushton 1€ në javë. Për ta çaktivizuar dërgoni një SMS falas me tekst STOP në 42246.





Rando DEVOLE

# SHQIPTARËT NË ITALI komuniteti më i madh. E më i ngulitur

Vetëm pak ditë më parë, Instituti italian i statistikës bëri të njohura të dhënat e fundit për imigracionin shqiptar. Prita që faqet e para të gazetave shqiptare të hapeshin me tituj si: "Shqiptarët: komuniteti më i madh në Itali", "Shqiptarët jashtë shtetit? Nuk martohen më", ose "Shqiptarët në Itali: martohen vetëm për të bërë fëmijë", por u zhgënjëva. Për nga pasaktësia do të ishin njëlloj si titujt e tjerë, për nga ngjallja e interesit diçka më shumë.

Siç edhe pritej, numri i përgjithshëm i shqiptarëve me banim në Itali është rritur. Me shifrën 441 mijë ata kapin tashmë vendin e parë midis bashkësive të ekstrakomunitarëve (ia kaluan paq edhe marokenëve) dhe vendin e dytë midis të huajve (renditen pas rumunëve). Me këta të fundit as që mund të dyluftohet statistikisht. Kanë armë, d.m.th. pasaporta, që ne as që i ëndërojmë dot. Nuk e kam fjalën për nga cilësia, se biometriket tona janë të paarritshme, por për faktin se janë anëtarë të BE-së, ndaj hyjnë e dalin sipas qejfit në Evropën-kështjellë e lirë. Betejë e barabartë mund të quhet me marokenët, meqë konsiderohemi bashkërisht nga postet kufitare si lebrozë të regjur. Këta (402 mijë) i lamë në bisht, dhe s'kanë pse të ankohen:

Mes rritjes konstante prej rreth 40.000 vetësh edhe këtë vit, në palët e statistikave vërehen edhe shifra që ndjellin hulumtim. Si për shembull numri i martesave mes shqiptarëve e të huajve. Të dhënat e martesave midis burrave italianë dhe grave të huaja, tregojnë se shqiptaret janë në vend të shtatë me 4,2% të martesave, rumunet që martohen me italianë zënë vend të parë (13%), më pas vijnë ukrainaset (10,4%), brazilianet (9,8%), polaket (6,6%), ruset (6%), moldavianet (4,8%). E pas nesh, marokenet.

thotë se shqiptaret janë më të afta e më të bukura se gratë marokene, sepse dinë t'ua prishin mendjen burrave të huaj. Por unë do ta refuzoja si maskilist këtë interpretim reduktiv. Përndryshe duhet të citoj edhe qëndrimin e femrave italiane, të cilat përdorin terma të rënda për gratë e huaja që u rrëmbejnë rregullisht burrat, fjalë të censurueshme për çdo mjet botimi, përfshirë blogjet. Xhelozinë do ta lija jashtë interpretimit: jam i bindur se baballarëve dhe vëllezërve shqiptarë nuk u vjen mirë. Por ndoshta gabohem, se kohët kanë ndryshuar.

Statistikat për vitin 2007 tregojnë se ka pasur 737 femra shqiptare që janë martuar me italianë (4,2%), kurse marokenet vetëm 677 ose 3,8%. Siç dihet, shifrat herë janë memece, herë llafazane. Por duhet t'ua njohësh gjuhën. Personalisht, nuk di si ta shpjegoj faktin që rumunet që martohen me italianë zënë vend të parë (13%), më pas vijnë ukrainaset (10,4%), brazilianet (9,8%), polaket (6,6%), ruset (6%), moldavianet (4,8%). Kinse në ndihmë të interpretimit, më vijnë kujtime të përziera me klishé nga e kaluara e Shqipërisë (si p.sh. ruset janë të bukura), ose klishé moderne pjellë kartolinash me plazhe të bardha borë (si p.sh. brazilianet kanë trup të bukur). Mirëpo, klishetë e mia më lënë në baltë kur shoh vendin e 15-të: kolumbianet. Po këto pse? Atëherë, në çastin më të vështirë, më vjen në ndihmë proverbi:

2007  
401.949  
2008  
441.073

PRANIA E SHQIPTARËVE NË ITALI NË VITE	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997
	2.034	22.188	28.628	30.847	31.926	34.706	63.987	75.650

nuk është faji ynë që brigjet italiane i kanë më larg se ne. Gjeografia është si matematika, nuk diskutohet.

Dyluftimi statistikor mes nesh dhe marokenëve është zhvendosur edhe në fushën e martesave, ku edhe dalin në pah disa tipare shqiptare që duhen hulumtuar më tej. Të dhënat e martesave midis burrave italianë dhe grave të huaja, tregojnë se shqiptaret janë në vend të shtatë, kurse marokenet renditen menjëherë më pas. Dikush mund të

”

Po midis tyre a martohen shqiptarët jashtë shtetit? Pak, shumë pak. Me sa duket, midis individëve me të njëjtën pasaportë, qenka e vështirë të biesh në dashuri në sheshet romantike italiane.

"Dashuria është e verbër".

Dyluftimet kërkojnë luajalitë. E pranoj që të dhënat statistikore për burrat e huaj të martuar me gra italiane dekretojnë humbjen e shqiptarëve. Në fakt, meshkujt marokene zënë vend të parë 19,4%, kurse burrat shqiptarë që janë martuar me femra italiane janë 10,1%, ose me vlera absolute 598. Ne zëmë vend të dytë, anipse jemi sa gjysma e marokenëve: shpresoj vetëm në kuptimin statistikor. Ajo që më ngushëllon

## shqiptarët dhe të huajt e tjerë në Itali


3.892.114

rezidentët e huaj  
në Itali më 1 janar  
2009 sipas  
studimeve ISTAT

441.073

shqiptarët rezide-  
ntë në Itali më 1  
janar 2009 sipas  
studimeve ISTAT

11,33%

e të huajve  
rezidentë në Itali  
janë shqiptarë.SHQIPTARËT  
mes të huajve

Të huajt rezidentë në Itali, më 1 janar 2009 mendohet të jenë rreth 3 milionë e 900 mijë, 463 mijë më shumë se një vit më parë. Mirë a keq, megjithëse ndokush nuk do ta pranojë multiethnicitetin, kjo është Italia sot. E thotë në Raportin vjetor, instituti statistikor italian që nxjerr në pah se në vitin 2008 popullsia rezidente në Itali ka kapërcyer për herë të parë shifrën e 60 milionë banorëve, dhe kjo është arritur pikërisht falë emigrantëve.

Duke i hedhur një sy raportit ISTAT, sheh që emigracioni drejt Italisë është një fenomen i qëndrueshëm dhe në rritje të vazhdueshme. Analiza e fundit i ngjan atyre të viteve të shkuara, me përjashtim të shifrave që rriten nga viti në vit. Rritet numri i përgjithshëm, për shkak të lindjeve dhe të ardhjeve, kryesisht për punë; rritet numri i të miturve, veçanërisht i të lindurve në Itali, dhe numri i nxënësve të huaj në shkollat italiane; rritet përqindja e të huajve në Veri të Italisë; shtohen martesat e përziera etj. Le të shohim disa aspekte duke u përqendruar veçanërisht në emigracionin shqiptar në Itali.

Nga rreth 3,9 milionë të huajt në Itali, rreth 1 milion e 900 mijë janë europianë,

Nga rreth 3,9 milionë të huajt në Itali, rreth 1 milion e 900 mijë janë europianë, komunitarë ose jo. Rumunët janë komuniteti më i madh me 780.421 vetë, ndërsa të dytët renditen shqiptarët, kombësia më e përfaqësuar nga jokomunitarët, me 441.073 vetë. Në një vit, numri i shqiptarëve është rritur me 9,7%, 39.124 vetë më shumë se më 1 janar 2008.

është se rumunët janë andej nga fundi, çka mund të interpretohet nga të zellshmit si paafësi në dashuri, por kjo bie poshtë nga fakti se spanjollët, me sharmin e tyre të padiskutueshëm, janë edhe më poshtë. Po ta shikonim me terma import/eksport do të

Mirëpo, statistikën janë si gota e mbushur përgjysmë: mund të shihet bosh e plot njëkohësisht. Mjafton të hedhësh sytë nëpër tabelat e grafikë. Në fakt, po të shqyrtohen të dhënat e fëmijëve të lindur nga çiftet me ose pa të huaj

1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
91.537	133.019	142.066	144.120	172.834	270.383	316.659	348.813	375.947

thoshim se kemi dhënë rreth 734 femra dhe kemi marrë 598 të tilla. Kemi deficite, por nuk kemi të dhëna lidhur me cilësinë.

Po midis tyre a martohen shqiptarët jashtë shtetit? Pak, shumë pak. Me sa duket, midis individëve me të njëjtën pasaportë, qenka e vështirë të biesh në dashuri në sheshet romantike italiane. Gjatë vitit 2007 kanë vënë unazë 178 shqiptarë e shqiptare, në përqindje janë rreth 3,3%, shumë pak në krahasim me rumunët 16% dhe marokenët 8,2%.

del se fëmijët me nëna shqiptare e baballarë italianë zënë vend të pestë (875 - 4,8% e gjithësi para marokenëve), fëmijët me baballarë shqiptarë e nëna italiane zënë vend të parë (549 - 11,6%), kurse fëmijët e lindur nga prindër shqiptarë zënë vend të tretë (8.198 - 13,2% edhe pse pas marokenëve). Me fjalë të tjera, po të shohim vlerat absolute, në riprodhim nuk na merr kush. Sidomos ndër vedi.

komunitarë ose jo. Rumunët janë komuniteti më i madh me 780.421 vetë, ndërsa të dytët renditen shqiptarët (që janë kombësia më e përfaqësuar nga jokomunitarët) me 441.073 vetë. Në një vit, numri i shqiptarëve është rritur me 9,7% (39.124 vetë më shumë se më 1 janar 2008).

Sipas ISTAT-it është puna ajo që shtyn emigrantët të vijnë në Itali. Nga të dhënat mbi hyrjet e jokomunitarëve gjatë

## Shqiptarët mes të huajve

vijon nga faqja 3

vitit 2007 vërehet që 150 mijë kanë ardhur për motive pune ndërsa rreth 70 mijë për motive familjare dhe rreth 30 mijë për motive të tjera.

Për shqiptarët në veçanti mund të thuhet që emigracioni prek fillimisht burrat që vijnë për punë e më pas gratë që në të shumtën e rasteve vijnë për arsye familjare. Kështu nga hyrjet e vitit 2007 vërehet që 71,2% e 16.837 shqiptarëve kanë ardhur për punë, ndërsa 72,3% e 12.435 shqiptarëve kanë ardhur në Itali me nulla osta për bashkim familjar. Dëshmon në këtë aspekt edhe fakti që 70,8% e grave shqiptare të ardhura në vitin 2007 janë të martuara (ndërkohë që vetëm 50,9% e të gjitha emigranteve të ardhura në Itali gjatë vitit 2007 janë të martuara). Po të shihet vjetërsia e emigracionit dallojmë që 36% e lejeve të qëndrimit që u ishin lëshuar burrave shqiptarë më 1 janar 2008, kanë për titullarë të ardhur në Itali para vitit 1998, ndërsa për gratë kjo përqindje zbrit në 18,3% (për emigrantët në përgjithësi këto përqindje janë përkatësisht 37,4 për burrat e 23,4 për gratë).

Sa për shpërndarjen në territor të emigrantëve, të dhënat që sjell ISTAT në këtë raport janë ato të 1 janarit 2008, për të cilat kemi shkruar edhe tjetër herë, por që shkurtimisht mund t'i përmbledhim duke thënë që emigrantët parapëlqejnë Italinë e Veriut dhe në krahina të caktuara kanë përbëjnë edhe mbi 8% të popullsisë si në Emilia Romagna (8,6%), në Umbria (8,6%), në Lombardi (8,5%), në Veneto (8,4%). Shqiptarët janë të përqendruar edhe ata në Veri, por janë të pranishëm në të gjitha provincat italiane. Mbi-zotërojnë në Puglia (ku përbëjnë 38,1% të të gjithë të huajve rezidentë në krahinë), Toskanë (23,8%), Marche (19,9%) dhe Trentino Alto Adige (16,4%). ke.bi.

## Konsullatat kroate japin sërish vizat e transitit për shqiptarët

Falë ndërhyrjes zyrtare të ambasadës shqiptare në Romë, pas ankesave të shumë shtetasve, konsullatat kroate të Milanos dhe Triestes shtojnë personelin dhe rinisin dhënien e vizave të transitit

Me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të Ambasadorit Llesh Kola dhe të ministrit fuqplotë Zef Bushati, konsullatat e Kroacisë kanë rinisur dhënien e vizave të transitit, të bllokuara në fillim të majit deri në fund të gushtit, pikërisht në periudhën më të nevojshme për shqiptarët që jetojnë në veri të Italisë.

Një notë proteste e një grupi shqiptarësh që jetojnë në veri të Italisë, si dhe telefonata të shumta personash të veçantë në redaksi na bënë të ditur këtë problem. Për arsye ekonomike dhe komoditeti, janë të shumtë shqiptarët, veçanërisht ata që jetojnë në Italinë e veriut që për të shkuar në atdhe zgjedhin rrugën tokësore, duke kaluar nga Italia në Slloveni e Kroaci, për të mbërritur në Shqipëri. Duke qenë se Sllovenia është në BE, për të udhëtuar nëpër të mjafton leja e qëndrimit, ndërsa për t'u futur në tokën kroate nevojitet akoma vizë transitit, për të cilën shqiptarët fillojnë e mendojnë muaj përpara. Këtë vit, ashtu si edhe vjet - sipas shqiptarëve që na kontaktuan - në maj konsullatat kroate të Triestes dhe Milanos bllokuan lëshimin e këtyre vizave deri më 20 gusht.

Pas përpjekjesh të shumta për t'u lidhur me Konsullatat dhe Ambasadën kroate, i përcollëm këtë shtetësim ambasadës shqiptare në Romë. Përgjigja që thuajse e menjëhershme: ambasada i ka rënë pas kësaj çështjeje dhe e ka zgjidhur brenda një kohe të shkurtër. Me ndërhyrjen e ambasadës sonë,

pranë ambasadës kroate, dhe të ministrisë së Jashtme shqiptare - të njoftuar nga ambasada për këtë problem - pranë ministrisë së Jashtme kroate, problemi duket se u zgjidh.

Sipas burimeve nga ambasada shqiptare në Romë, bllokimi i vizave të transitit nga Konsullatat kroate ka për shkak personelin e tyre të kufizuar në numër (konsullatat e Milanos dhe Triestes kishin vetëm një konsull) që nuk arrin të përballojë fluksin e madh të shqiptarëve gjatë periudhës së verës. Ndaj për zgjidhjen e problemit të vizave, u pa e arsyeshme ndërhyrja më lart, në ministrinë e Jashtme kroate, me ndërmjetësimin e ministrisë homologe shqiptare dhe të ambasadës sonë në Zagreb.

Brenda një kohe të shkurtër, ministria e Jashtme kroate me një letër zyrtare ka pohuar se "nuk është e ligjshme të bllokohe vizat transitit", thonë në Ambasadën tonë.

"Ambasada kroate, nga ana e saj, pasi komunikoi me Ministrinë e Jashtme kroate ka njoftuar se ka filluar lëshimin i vizave transitit për qytetarët shqiptarë që udhëtojnë për Shqipëri në rrugë tokësore nëpërmjet Kroacisë. Madje, autoritetet kroate kanë shtuar personelin e Konsullatave në Trieste dhe Milano për të përballuar kërkesat për viza dhe shërbime të ndryshme të qytetarëve" bëhet e ditur, në një njoftim për publikum, në faqet internet të Ambasadës shqiptare.

s.i.

### OFERTË PUNE

**SALLON BUKURIE NË ROMË, ZONA DUE LEONI, ME AKTIVITETE ESTETIKE DHE PARRUKERIE, KREJTËSISHT TË KONSOLIDUARA, KËRKON DY PUNONJËSE, EKSKLUSIVISHT SHQIPTARE:**

*Një estetiste me përvojë pune, të diplomuar në Itali, me moshë deri në 25 vjeç, eksperte në trajtimet e fytyrës dhe të trupit, në shitjen e produkteve dhe në përdorimin e pajisjeve teknike*

*Një parrukiere të diplomuar në Itali, me diplomë të vitit të tretë, me përvojë pune, me moshë deri në 25 vjeç, eksperte në klientelë femërore, në shitjen e produkteve, në përdorimin e aparaturave të ndryshme*

**Ofrohet ambient serioz e elegant pune, dhe një klientelë e përzgjedhur**

**Pagesa fikse + përqindje mbi faturimin**

**Të interesuarat të dërgojnë një kurrikulum të plotë në adresën email [estetica.kotorri@yahoo.it](mailto:estetica.kotorri@yahoo.it)**

**Kërkohet seriozitet, profesionalizëm dhe paraqitje**

**shqiptari i italisë**

l'albanese d'italia

e përmuajshme suplement i  
**Bota shqiptare**  
gazeta e shqiptarëve në itali

BOTIM I / EDITORE Edizioni Bota shqiptare srl - (Il mondo albanese)

REDAKSIONI / REDAZIONE

Viale Marco Polo 119, 00154 ROMA

Tel 06-57289240 Fax 06-62209543 Cell. 339-3798796

Regjistruar në Regjistrin e Shtypit të Gjykatës së Romës.

BOTA SHQIPTARE Ë ISCRITTO AL REGISTRO STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA AL nr. 213/99 del 12/05/1999.

[www.botashqiptare.net](http://www.botashqiptare.net) [redaksia@botashqiptare.net](mailto:redaksia@botashqiptare.net)

DREJTOR BOTIMI / DIRETTORE EDITORIALE Roland Sejko KRYEREDAKTOR / CAPOREDATTORE Arta Bardhi REDAKTORË / IN REDAZIONE Keçi Biçoku, Albana Temali, Marjola Rukaj

NË BASHKËPJUNIM ME / IN COLLABORAZIONE CON Edizioni Stranieri in Italia

STAMPA: Centro Stampa Quotidiani S.p.A - via dell'Industria 52 - 25030 Erbusco (BS)



Vodafone One Nation New

## Që sot, vendlindja jote është më afër.

Një tarifë e vetme për Italinë dhe për vendin tënd.  
15 qindarka në minutë përgjithmonë.

Aktivizo falas Vodafone One Nation New dhe do të kesh 1000 minuta në muaj për të komunikuar me vendlindjen tënde duke paguar përgjithmonë vetëm 15 qindarka. Për informacione mbi planin dhe vendet në të cilat aplikohet kjo tarifë, lutemi të vizitoni faqen e internetit [www.vodafone.it](http://www.vodafone.it)

Tarifa paguhet përpara 60 sekondave të parë të telefonatës dhe ka vlerën 15 qindarka. Shuma e paguar në momentin e përgjigjes është 16 qindarka.

**Life is now**



## KARTA E QËNDRIMIT



Vrapi drejt kartave të qëndrimit para ardhjes në fuqi të paketës së sigurisë

**Shtohen kërkesat për kartën e qëndrimit. Kush e kërkon tani i shpëton taksës mbi përtëritjet dhe testit të gjuhës italiane**

Nga njëra anë taksa nga 80 deri në 200 euro për përtëritjen e dokumentit të qëndrimit, nga ana tjetër testi i detyrueshëm i gjuhës italiane për të marrë kartën e qëndrimit. Në mes, qindra mijëra të huaj në Itali të shqetësuar për të rejtat që sjell ligji i ri i sigurisë.

Rezultati është që shumë të huaj po nxitojnë të kërkojnë kartën e qëndrimit - apo siç quhet sot leje-qëndrimin BE për qëndruesit afatgjatë, - para se të hyjnë në fuqi normat e reja. Sepse kjo super-leje, që u takon të huajve me qëndrim të rregullt prej mëse pesë vjetësh, nuk ka afat skadimi, pra nuk është subjekt përtëritjesh të kushtueshme, dhe tani për tani nuk kërkon që mbajtësi i këtij dokumenti të njohë gjuhën italiane.

"Ka një rritje të fortë të kërkesës, sigurisht të lidhur me taksën e re të përtëritjes së lejeve të qëndrimit, që edhe tani u kushton shtrenjtë të huajve. Kështu, kush vjen në zyrat tona pyet menjëherë nëse mund të kërkojë kartën e qëndrimit" konfirmon Maurizio Bova, përgjegjës i imigracionit i sindikatës Cisl të Milanos. "Madje - nënvizon Bove - me krizën ekonomike që po kalojmë merr një rëndësi të veçantë marrja e një dokumenti që mbetet i vlefshëm edhe nëse humbet vendin e punës".

Sindikalisti drejton gishtin kundër Kuesturave që pengojnë lëshimin e kartave të qëndrimit. "Në disa provinca, pretendojnë që kush ka lejen të sapo skaduar të kërkojë fillimisht përtëritjen dhe vetëm pasi t'i lëshohet leja e re të kërkojë kartën e qëndrimit. Cështu - komenton Bove - nuk bëhet gjë tjetër veçse rritet koha e pritjes dhe shtohen shpenzimet".

"Edhe në vëmë re një rritje të fortë të kërkesës. Jo vetëm për shkak të paketës së sigurisë që sidoqoftë, me perspektivën e kostove më të larta dhe të testit të gjuhës, ka qenë një shtysë e rëndësishme. Megjithatë, kur dikush u drejtohet sporteleve tona për të përtërirë lejen e qëndrimit, verifikojmë gjithnjë nëse përmbush kushtet për të kërkuar drejtpërdrejt kartën, dhe nëse po i këshillojmë ta kërkojë" thotë Pino Gulia, përgjegjës imigracioni i ACLI-t.

Po mes emigrantëve është e qartë se ç'ndryshon me ardhjen në fuqi të paketës së sigurisë? "E dinë që do të ketë shumë risi, si taksa mbi përtëritjet, por shpesh informacioni është i filtruar nga kalimi gojë më gojë apo i shtrembëruar nga organet e shtypit". Sipas Gulia-s "nevojitet një informacion serioz e kapilar mes komuniteteve të të huajve".

Elvio Pasca



shqiptari

italiane.com

portali i komunitetit shqiptar në Itali

TANI EDHE ONLINE

Punonjësit e varur që gjatë jetës së tyre kanë derdhur kontributet shoqërore, në prani të kushteve minimale të moshës dhe të kontributeve të parashikuara nga ligji, kanë të drejtën e pensionit.

### Pension pleqërie

#### Pensione di vecchiaia

Pensioni i pleqërisë aktualisht u njihet punonjësve që kanë derdhur të paktën 20 vjet kontribute dhe që kanë mbushur moshën për të dalë në pension, për burrat është 65 vjeç dhe për gratë 60 vjeç (për personat invalidë 80% dhe për të verbërit kjo moshë është 60 vjeç për burrat dhe 55 vjeç për gratë).

Kushtet e kërkuara janë:

- mosha për pension;
- vitet minimale të kontributeve;
- ndërprerja e marrëdhënies së punës.

Shuma e pensionit ndryshon sipas sistemit të përlogaritjes: sistemi sipas rrogës (sistema retributivo) llogaritet në bazë të rrogës së marrë gjatë viteve të fundit të punës; sistemi sipas kontributeve (sistema contributivo) llogaritet mbi shumën e përgjithshme të kontributeve të derdhura, të rivlerësuar mbi ecurinë e Prodhimit të Brendshëm Bruto; sistemi i përzier (sistema misto), siç e thotë edhe emri, llogaritet mbi rrogën dhe kontributet dhe aplikohet për ata që në 31 dhjetor 1995 kishin vjetërsi kontributeve më të ulët se 18 vjet.

### Pension vjetërsie pune

#### Pensione di anzianità

Ky pension u njihet punonjësve, edhe para se të kenë mbushur moshën e kërkuar për të dalë në pension pleqërie, që kanë ndërprerë marrëdhënien e punës dhe përmbushin kushte të caktuara.

Nga 1 janar 2009 deri në 30 qershor 2009 kushtet e kërkuara me ligj janë 35 vjet kontribute dhe mosha të paktën 58 vjeç. Kush ka derdhur kontribute për 40 vjet mund të marrë pension vjetërsie edhe nëse ende nuk ka mbushur moshën e kërkuar më lart.

Nga 1 korriku 2009 ky pension u njihet punonjësve sipas përlogaritjes së kuotave. Praktikisht punonjësi du të ketë të drejtën e pensionit kur arrin një kuotë të llogaritur sipas shumës së viteve të moshës me vitet e kontributeve të derdhura (minimumi i viteve të kontributeve është 35). Mbetet e pandryshuar që kush ka derdhur kontribute për 40 vjet mund të marrë pension vjetër-

sie pavarësisht nga mosha që ka.

Për shembull, nëse sot një punonjës është 59 vjeç e ka derdhur kontribute për 38 vjet, ka të drejtën e pensionit të vjetërsisë pasi kuota e tij është  $59+38=97$ , pra më e lartë se kuota e kërkuar 95 që parashikon ligji (shih tabelën).

### Paraqitja e kërkesës për pension

Për pensionin e pleqërisë apo të vjetërsisë në punë i bëhet kërkesë institutit të sigurimeve shoqërore, INPS. Kërkesa e përpiluar në formularë të posaçëm (që gjenden në selitë e INPS-it apo mund të shkarkohen nga faqet internet të këtij instituti [www.inps.it](http://www.inps.it) në seksionin "moduli") dhe e shoqëruar nga i gjithë dokumentacioni i kërkuar, mund të paraqitet ose drejtpërdrejt në zyrat e INPS-it, ose të dërgohet atje me postë, ose t'i përcillet përmes patronateve që ofrojnë asistencë falas.

# E DREJTA E PENSIONIT

## NGA PENSIONI I PLEQËRISË TE AI FAMILJAR

I njihni të gjithë llojet e pensioneve në Itali? Punonjësit e varur që gjatë jetës së tyre kanë derdhur kontribute shoqërore, në prani të kushteve minimale të moshës dhe të kontributeve të parashikuara nga ligji, kanë të drejtën e pensionit. Dhe jo vetëm ata.

Tabela INPS - Kushti i kontributeve shoqërore, minimumi 35 vjet

Periudha	Punonjësit e varur		Punonjësit e pavarur	
	Shuma moshë+vjetërsi pune	Mosha minimale	Shuma moshë+vjetërsi pune	Mosha minimale
Nga 01/07/2009 deri më 31/12/2010	95	59	96	60
Nga 01/01/2011 deri më 31/12/2012	96	60	97	61
Nga 01/01/2013	97	61	98	62

Për të pasur informacione të detajuara mbi këtë argument këshillohet që të interesuarit të kontaktojnë INPS-in në numrin e gjelbër 803.164.

### E drejta e pensionit e shtetasve të huaj

Qytetarët e huaj jokomunitarë që kanë punuar në Itali dhe në vendlindje, në prani të Konventave dypalëshe mes Italisë dhe vendit të tij, mund të mbledhin kontributet e derdhura në këto dy vende, për të drejtën e pensionit. E themi që në fillim që nuk është rasti i Shqipërisë: megjithë numrin e lartë të shqiptarëve në Itali, ende nuk ka një marrëveshje mes Shqipërisë dhe Italisë mbi këtë aspekt të rëndësishëm për emigrantët.

**Pensionin e të huajve nga shtete që nuk kanë marrëvesh-**

### je me Italinë

Shtetasit e vendeve jo anëtare të BE-së që nuk kanë nënshkruar marrëveshje me Italinë lidhur me pensionet, nuk mund të përfitojnë mbledhjen e viteve të punës në atdhe dhe Itali, pra nuk mund të bëjnë "totalizimin e periudhave kontributeve" por kanë të drejtën e pensionit italian nëse përmbushin kushtet minimale të moshës dhe të kontributeve të derdhura. Ata që kthehen në vendlindje, edhe pse nuk mund të marrin kontributet e derdhura në Itali, - në fakt ligji Bosi-Fini ka shfuqizuar normën që parashikonte këtë mundësi kur i huaj vendoste të kthehej përfundimisht në atdhe - sidoqoftë do të mund të marrin pensionin italian edhe në atdhe, gjithnjë nëse këtu përmbushin kushtet. Pra një shqiptar që vendos të kthehet në atdhe në moshë të pleqërisë dhe ka punuar mbi 20 vjet në Itali, do të mund të marrë

edhe në Shqipëri shumën e pensionit të pleqërisë që i takon nga Italia.

### Vendet e huaja që kanë marrëveshje dypalëshe me Italinë

Vendet jo anëtare të BE-së që kanë nënshkruar Konventa dypalëshe me Italinë për pensionet, konventa që aplikohen vetëm për shtetasit e vendeve kontraktuese, janë: Brazili, Republika e Kepit të Gjelbër, Kroacia, Jersey-Ishujt e Kanalit, Principata e Monakos, Turqia, Turqia dhe Shtetet e ish Republikës Federative të Jugosllavisë: Bosnje-Hercegovina, Maqedonia e Mali i Zi.

### Shtetasit e Bashkimit evropian

Shtetasit e BE-së mund të mbledhin periudhat e punës në territorin e vendit të tyre me ato të Italisë pasi Italia aplikon Rregulloret Komunitare që parashikojnë për të drejtën e pensionit përdorimin e kontributeve të derdhura në vende të ndryshme të BE-së.

### Pension për të mbijetuarit

#### Pensione ai superstiti

Në këtë rast është fjala për një pension që u njihet, pas vdekjes së punonjësit që derdh kontributet apo të pensionistit, familjarëve që e kanë këtë të drejtë, të cilëve u takon:

- pensioni familjar (pensione di reversibilità) kur personi që ka vdekur ishte në pension;

- pensioni i tërthortë (pensione indiretta) kur personi, në çastin e vdekjes, kishte të paktën 15 vjet kontribute ose ishte i siguruar prej të paktën 5 vjetëve, nga të cilët 3 në pesëvjeçarin e fundit para datës së vdekjes.

Familjarët që kanë të drejtën e këtij pensioni janë:

- bashkëshorti, edhe nëse jeton më vete (separato) ose është i divorcuar, që nuk është rimartuar (bashkëshortit që jeton më vete (por jo të divorcuar) i takon pensioni nëse ka të drejtën e çekut të mbështetjes ekonomike, ndërsa bashkëshortit të divorcuar nëse është titullar i çekut të divorcit);

- bijtë (të ligjshëm, jashtë martese, të adoptuar, të njohur ligjërisht ose të deklaruar me gjyq, të lindur nga martesa të mëparshme të bashkëshortit tjetër) që në datën e vdekjes së prindit janë të mitur, studentë ose të paafitë për punë dhe në ngarkim të tij;

- nipat e mitur në ngarkim të personit që ndërron jetë (gjyshi apo gjyshja).

Në mungesë të këtyre familjarëve, kanë të drejtën e këtij pensioni prindërit nëse kanë mbushur 65 vjeç dhe nuk kanë ndonjë pension të tyrin, ose në mungesë edhe të këtyre të fundit, vëllezërit e motrat e pamartuara nëse janë në ngarkim të personit që ndërron jetë.

Pensionin i jepet familjarëve nga muaji pas vdekjes së personit të siguruar apo të pensionistit, pavarësisht nga data e paraqitjes së kërkesës.

Formularët për kërkesën janë në dispozicion të publikut në zyrat e INPS-it ose mund të shkarkohen nga faqet internet [www.inps.it](http://www.inps.it) në seksionin "moduli". Kërkesa, e plotësuar nga i gjithë dokumentacioni i kërkuar, mund të paraqitet ose drejtpërdrejt në zyrat e INPS-it, ose të dërgohet atje me postë, ose t'i përcillet përmes patronateve që ofrojnë asistencë falas.

Për të pasur informacione të detajuara mbi këtë argument këshillohet që të interesuarit të kontaktojnë INPS-in në numrin e gjelbër 803.164.

**Ardian Cania, student, Firenze**

**D**oja të shprehja një shqetësim si student që ndodhet larg vendit nga ku është lindur, rritur dhe pjekur. Është viti i shtatë që jetoj, studioj në një nga qendrat e kulturës, artit dhe qytetarisë botërore, në qytetin e Firences në Itali.

Është e pashmangshme që t'i shpëtosh gjatë këtyre viteve skalitjes së jetës me kulturën e kësaj bote sa të re aq dhe të vjetër.

Ashtu si unë, janë të shumtë studentët shqiptarë që studiojnë në shumë qendra të botës, nga ku janë duke u formuar si profesionistë të ardhshëm. Jam larguar nga Shqipëria, sapo kam mbaruar shkollën e mesme dhe sapo më kanë quajtur të pjekur, me dëshirën dhe ëndrrën për të jetuar e studiuar në një botë të re, në një kulturë të re.

Jam larguar nga një vend, nga një vend që në atë moshë më thoshte veçse ik dhe vetëm ik. Sa hap e mbyll sytë jam gjendur në botën që aq shumë e kisha dëshiruar, të parë veçse nga largësia e televizionit.

Fillon një jetë e re, fytyra të reja, rregulla të reja, ndërtime të reja.... Çdo gjë ndryshe!

Vitet ndjekin dalëngadalë njeri-tjetrin pa u ndier. Malli për vendlindjen është kthyer në një kujtim, sepse tashmë rreth meje janë dhe dhjetëra studentë të tjerë.

Të gjithë përpiqemi me sa mundemi që me studimin, punën tonë dhe sjelljen të ndikojmë sadopak në të mirë të vendit tonë, edhe pse jemi larg. Përpiqemi, që me anë të veprimtarive të ndryshme kulturore dhe shoqërore, si studentë të tregojmë dhe të shfaqim Shqipërinë e vërtetë. Atë Shqipëri që pak veta e njohin, të thyejmë mite që tashmë njihen nga cilido.

Por a mjaftojmë vetëm ne si studentë?

Nga gjithë këto vite kam arritur në përfundimin se bota është e larmishme dhe në larminë e saj mirëpret dhe respekton shqiptarët e ndershëm, të punës dhe ata të kulturës. Ndoshta më shumë nga çfarë mund të mendohet.

Nga ana tjetër, është për t'u pikëlluar kur sheh se jo e njëjta gjë ndodh me shtetin shqiptar.

Mendoj se nuk ka shqiptar që mund të gjejë një shpjegim të arsyeshëm për këtë sjellje të çuditshme dhe arrogante të shtetit shqiptar.

Nga data 25 prill deri më 3



## SHQIPËRI-ITALI

# Sa afër, e sa larg jemi

Në gjithë këto vite si student në Itali kam arritur në përfundimin se bota është e larmishme dhe në larminë e saj mirëpret dhe respekton shqiptarët e ndershëm, të punës dhe ata të kulturës. Ndoshta më shumë nga çfarë mund të mendohet. Nga ana tjetër, është për t'u pikëlluar kur sheh se jo e njëjta gjë ndodh me shtetin shqiptar...



maj, këtu në Firenze u mbajt veprimtaria "Mercato Internazionale dell'Artigianato", në shqip "Tregu Ndërkombëtar i Artizanatit".

Një ndër shumë veprimtaritë kulturore dhe artistike që mbahen çdo muaj në këtë qytet të kulturës, në kështjellën që ndodhet në zemër të qytetit. Të gjitha këto veprimtari vizitohen nga mijëra turistë nga e gjithë bota.

Bashkë me shumë miqtë të mi studentë isha dhe unë të shihja punën e duarartëve nga e mbarë bota. Kemi shëtitur për rreth katër orë më radhë në të gjithë pavijonet e mundshme. Kemi parë të gjithë botën aty. Kishte pavijone nga Amerika Latine, Afrika, Azia e largët. Pothuajse të gjitha vendet e Evropës. Një shumëllojshmëri punimesh nga më të bukurat dhe nga më të çuditshmet.

Më bëri shumë përshtypje që në pavijonin e Rusisë ndër të tjera kishte shumë stema dhe simbole ushtarake të një regjimi të rënë me kohë.

Po ne? Shqipëria apo Albania? Në çfarë pike të këtij planeti artizanësh ndodheshim?

Të gjithë e dimë se duarartët shqiptarë arrijnë të bëjnë gjëra të mrekullueshme. Ishim dhe ne në legjendën që shpjegonte vendosjen e pavijoneve, por në vendin dhe numrin e caktuar gjendej pavijoni i një shteti tjetër!!! Jemi ndër shumë të trishtuar, gati të pikëlluar. Kërkoam përshtur se mos kishte ndodhur ndonjë gabim. Ishte e kotë!

**Përsiatje pas kërkimit të dështuar të një pavioni shqiptar në Fiera Internazionale dell'Artigianato në Firenze**

Shqipëria nuk merrte pjesë!!! Pse vallë kështu?

A jemi larg nga Firenze dhe Italia? A mos vallë ne si shqiptarë nuk kemi art dhe artizanat për të paraqitur? Apo ndoshta nuk na kanë ftuar?!

Këtë të fundit nuk e besoj. Pasi u informova, u bëra me dije se vitin e kaluar po në Firenze, organizatorët i kishin dhënë Shqipërisë një hapësirë FALAS, që të paraqiste artin dhe kulturën e saj. Vendet e tjera duhet të paguajnë për këtë gjë! Edhe në këtë rast Shqipëria nuk kishte marrë pjesë, sepse pala shqiptare nuk e kish vënë ujin në zjarr, sepse ndoshta kishin kuptuar se nuk kishte përfitim vetjak për xhepat e burokratëve shqiptarë.

A mos vallë nuk kemi njerëz me aq kulturë në Ministrinë e Kulturës apo gjatë, sa të dinë të kuptojnë sesa vlera ka puna e shqiptarëve, sa kulturë të trashëguar ka Shqipëria dhe se si duhet të përfaqësohet Ajo në botë?

Fjalët janë vetëm fjalë! Dy vjet ikën! Dy vjet rresht pa u përfaqësuar në një nga qendrat botërore të artit dhe kulturës! Sikur vetëm shqiptarët të blinin në atë pavijon, do të kish qenë një arritje ekonomike, meqenëse në kohët e sotme bëhen përpjekje me çdo kusht që të bëhet para një matëse.

Fatkeqësisht vë re se dëshira e botës së qytetëruar për të na ndihmuar është më e madhe sesa vullneti ynë për të ndryshuar!

Kjo është diçka që më pikëllon pa masë.





**MOS I VËR KUFIJ ZËRIT TËND.**

## **Mjaftojnë 10 qindarka për t'u ndier në shtëpi.**

Aktivizo Call Your Country: flet me Shqipërinë duke filluar nga 10 qindarka në minutë. Madje, me Noi Wind, me vetëm 6 euro në muaj mund të flasësh falas me të gjithë celularët Wind për 200 minuta në muaj.

Aktivizim falas për të gjithë klientët e rinj deri më 26 korrik 2009

Call Your Country ka kosto gjashtëmujore prej 4 eurosh. Tarifa drejt celularëve është 10 qindarka në minutë. Impulsi i përgjigjes 15 qindarka. Tarifimi çdo 60 sekonda. Për informacione [www.wind.it](http://www.wind.it)



**WIND**

## Blendi Fevziu, TvKlan

Blendi Fevziu: Shpresoj që Shqipëria që gjetët të jetë ajo që ne mendojmë, jo ajo që shfaqet në mediat e huaja...

**Bruno Vespa:** Gjykimet që jepen mbi gjërat që nuk njihen, shpesh janë të pasakta. Unë gjeta një demokraci shumë të fortë, më duket shumë korrekte, një motivim të madh për zgjedhjet e ardhshme.

## Edhe plot pasion.

Po, shumë e fortë, shumë... Megjithatë duhet të them me stil. Takova Kryeministrin, kreun e opozitës. Nesër do të takoj Presidentin e Republikës, Kryetaren e Kuvendit. Pra, një kuadër i plotë. Mu dukën persona të kategorisë së parë, me një vizion ndërkombëtar shumë konkret, shumë të përditësuar, por mbi të gjitha me perspektiva zhvillimi për Shqipërinë, të them të drejtën, të pabesueshme. Ky është vend që në vitin e tmerrshëm 2009, ku të gjithë vendet janë me shenjë minus, ju keni mundësinë e një +4% të prodhimit të brendshëm bruto.

Thonë gjithmonë se vendet që nuk janë të integruar mirë, kjo që është gjëja më e keqe e ekonomisë së tyre, është edhe më e mira në çastet e krizës.

Po. Këtu demokracia ka pak vite që ka ardhur, pra zhvillimi ekonomik është shumë i madh. Ju duhet të rifitoni gjithë kohën e humbur gjatë viteve të diktaturës.

## Gjysmë shekulli.

Po, gjysmë shekulli. Por ju gjatë 17 vjetëve, sidomos në dhjetë vitet e fundit, keni rifituar shumë.

Ky përmirësim që shihet në Shqipëri, ndihet edhe jashtë saj?

Në jemi partneri numër një i Shqipërisë. Para se të vija këtu bisedova me Ministrin e Jashtëm, ai më bëri një përshkrim vërtet entuziast të Shqipërisë. Kam lexuar dhe raportet mbi Shqipërinë dhe kemi raporte vërtet fantastike.

Thonë gjithmonë se imazhi i shqiptarëve në Itali, por dhe në vende të tjera, është imazhi i "Boat people", imazhi i njerëzve që iknin nga vendi me anije...

Jo, jo... Unë në atë kohë, në vitin '91, kam adoptuar si të thuash një djalë që erdhi me varkë. Ishin tre djem, dy prej të cilëve i ndihmoi Andreotti dhe njërin unë për shumë vite. Do të thosha jo, atë gjë e kemi harruar tashmë. Ka qenë një periudhë, por tashmë e largët, por që edhe ajo është harruar, kur disa shqiptarë të cilët nuk ndiheshin mirë në Itali bënëin gjëra që s'duheshin bërë...

## Bisedoi Blendi FEVZIU, Tv KLAN



Nuk e dinte se ishte aq i famshëm në Shqipëri. Njerëzit që e takonin i shtrëngonin dorën dhe dëshironin të bënëin fotografi me të. Dashamirësia e njerëzve, natyra e bukur, por edhe ndryshimet e mëdha në një vend ish-komunist, të izoluar për 50 vjet me radhë, i bënë shumë përshtypje gazetarit italian, Bruno Vespa. Disa javë më parë, me nismën dhe përkujdesjen e agjencisë së njohur të shërbimeve "Alba di Mirela Dracini", ai zhvilloi një vizitë në Shqipëri, ku takoi krerët e shtetit shqiptar dhe më pas dha këtë intervistë në emisionin "Opinion", në TV Klan, ku tregoi për veten, por edhe si e shikonte Shqipërinë, apo ç'kishte dëgjuar për vendin ish-komunist. Vespa tregon gjithashtu dhe përpjekjet e dështuara për të ardhur në Shqipëri, rreth 30 vjet më parë.

## AGJENCIA ALBA, JO VETËM SHËRBIME PËR EMIGRANTËT



Drejtuar nga Mirela Dracini studioja e njohur e Romës që organizoi vizitën e Bruno Vespës në Shqipëri është prej vitesh e angazhuar në veprimtari që shkojnë përtej thelbit të saj si agjenci shërbimesh për dokumentet e emigrantëve

**Prej vitesh e angazhuar në konsulencën dhe ndihmesën për përgatitjen e dokumenteve të shqiptarëve në Itali, Studio Alba e Romës drejtuar nga Mirela Draçini ka kohë që ka zgjeruar veprimtarinë e saj edhe si P.R. i politikanëve dhe biznesmenëve më të rëndësishëm italianë mes Shqipërisë dhe Italisë. Në këtë kuadër të bashkëpunimeve kulturore e politike Draçini organizoi vizitën dhe takimet e gazetarit Bruno Vespa dhe senatorit Mauro Fabris me personalitetet të kulturës dhe përfaqësuesit më të lartë të shtetit dhe qeverisë shqiptare. Ndër veprimtari të tjera me impakt të madh kulturor e politik të organizuara nga Studio Alba e Draçinit veçohet edhe ekspozita e organizuar para pak vitesh në Dhomën e Deputetëve të parlamentit Italian "L'amicizia tra Italia e Albania: passato, presente, futuro"**



Rreth 30 vjet më parë ishte vendosur që unë të isha gazetar i parë perëndimor, që do të hynte në Shqipëri gjatë regjimit të Enver Hoxhës. Zgjati dy vjet. Kolegët e mi talleshin me mua dhe thoshin: "S'do t'ia dalësh kurrë". Unë thosha: "Më kanë dhënë fjalën, pse jo?" Në fund nuk erdha, edhe pse mund të isha nën vëzhgim unë dhe kamera ime. Ju e imagjinoni vetë dhe e dini më mirë se unë

Por, absolutisht jo. Tashmë kjo gjë i përket së shkuarës. Sot Shqipëria është një partner i jashtëzakonshëm. Duhet të them se fjalët e Kryeministrit ishin shumë mbresëlënëse, kur më tha se brenda katër vitesh keni asfaltuar 5600 km rrugë.

Thatë se keni dashur ta vizitoni Shqipërinë para 30 vjetësh. Si ndodhi?

Rreth 30 vjet më parë, s'më kujtohet mirë nëse e bëmë ne kërkesën apo kërkesa erdhi nga qeveria shqiptare, por ishte vendosur që unë të isha gazetar i parë perëndimor, që do të hynte në Shqipëri gjatë regjimit të Enver Hoxhës.

Asnjë kamera e huaj s'kishte kaluar kufijtë?

Kurrë. Kurrë. Kurrë. Zgjati dy vjet. Kolegët e mi talleshin me mua dhe thoshin: "S'do t'ia dalësh kurrë". Unë thosha: "Më kanë dhënë fjalën, pse jo?"

Kush jua kishte dhënë fjalën?

Ambasadori.

Ambasadori shqiptar në Romë?

Po. Ambasadori shqiptar në Romë. Piva shumë, shumë konjak shqiptar gjatë bisedave me të.

Sot provova një konjak dhe vura re se edhe konjaku është përmirësuar shumë, përveç përmirësimit të demokracisë dhe mbarë vendit. Në fund nuk erdha, edhe pse mund të isha nën vëzhgim unë dhe kamera ime. Ju e imagjinoni vetë dhe e dini më mirë se unë si. S'mund të bëja asgjë që të mos ishte super e kontrolluar. Në fund vendosën t'ia besonin Nikola Karaçolos dhe një shoqërie produktioni italo-kinezo-shqiptare, e cila quhej "Alba-Cina" produktionin e këtij dokumentari që u transmetua në 1979. Që nga ai çast unë i hoqa vizën. Thashë: "Mirë, meqë s'më deshën, nuk do të shkoj më".

Bëtë edhe një shëtitje me helikopter. Ç'përshtypje keni për natyrën?

E bukur. E bukur, sepse keni gjithçka. Keni male të bukura, ku nuk ka ende impiante për ski, por kur të filloni... Këto male, veç të tjerash zbresin në det me shumë lehtësi. Keni kodra të kultivuara mirë dhe brigje të mrekullueshëm. Bëra një shëtitje përgjatë bregdetit. Shkuam deri në kufi me Greqinë, pastaj

# BRUNO VESPA

## “Vij në Shqipëri pas një ëndrre 40 vjeçare”



në Vlorë... Janë vërtet të bukura. Shumë të bukura, të shkretuara... Mos i prishni! Sepse po të bëhen shumë ndërtime, qoftë nga makutëria, nga nxitimi, mund të shkatërroni një pasuri fantastike. Nëse do të ndërtoni pak dhe mirë, ky mund të ishte një nga vendet më të bukura të Mesdheut.

Duke ju shoqëruar sot, pashë rrugëve sikurse dhe nëpër korridoret e studiove, që të gjithë donin të dilnin në fotografi me ju, t'ju takonin. E dinjtë që ishit kaq i famshëm në Shqipëri?

Jo. Në vitet '90, kur u bënë eksodet e para, kuptova se televizioni italian këtu ndiqej

shumë. Sot më lanë shumë mbresa dhe më emocionuan shumë fjalët e Kryetares së Kuvendit, kur më tha se ne, televizioni ynë, ku dhe unë sadopak me ndonjë emision, ka të ngjarë që i jepnim Shqipërisë shpresën për një ndryshim. Kjo më preku shumë, sepse e di çfarë keni ndër-

Si i shikoni ju si historian apo edhe si gazetar, marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Italisë?

Duhet të them diçka. Mua nuk më pëlqen kolonizimi, sepse nëse një vend shkon të një vend tjetër pa trokitur te dera, s'vpron mirë. Duhet të them se, duke parë disa vepra publike që

pashë sot, fashizmi ka lënë gjurmë të rëndësishme këtu. Gjithashtu, mësova se pas 8 shtatorit, sipas burimeve të ndryshme këtu mbetën 200, 170 mijë, ushtarë italianë të braktisur plotësisht. Shumë pak u bënë aleatë me nazistë etj., por pjesa më e madhe u mbrojt nga populli shqiptar. Kjo është diçka shumë e rëndësishme. Përderisa u mbrojt nga populli, duket që nuk është sjellë shumë keq. Madje, mendoj se ne italianët duhet t'u jemi shumë mirënjohës shqiptarëve që rrezikuan jetën për të mbrojtur ushtarët italianë. Sepse nazistët nuk bënë shaka. Nëse do t'i kishin

”

Mbyllja e regjimit shqiptar ishte vërtet e tmerrshme. Për më shumë se dy vjet u përpoqa... Unë s'do të kisha ardhur këtu si revolucionar, sepse s'do të isha në gjendje ta bëja. Do të vija për të treguar çfarë ishte Shqipëria.

Për këtë kishin frikë. Sepse mjaftonte të shikoje, për të kuptuar. Mjaftonte të shikoje, s'do të hynin në punë fjalët, mjaftonin pamjet. Do të kishin parë që në zemër të Evropës, dy orë larg me varkë nga Italia, ishte një vend që komunizmi e kishte kthyer me shekuj të tërë larg.

gjetur ushtarët italianë të fshehur nëpër shtëpitë e fshatarëve apo malësorëve shqiptarë do t'i kishin vrarë. Do të kishin vrarë dhe shqiptarët që i mbronin.

Si historian, por edhe si gazetar, pse Italia e harroi Shqipërinë komuniste për 50 vjet?

Shiko, Shqipëria... Politika ndërkombëtare është shumë cinike. Është e tmerrshme, nuk ka zemër.

Sidomos për vendet e vogla...

Sidomos për vendet e vogla. Shqipëria ishte zhdukur nga harta gjeografike, sepse kishte regjimin më të mbyllur do të thosha. Mirë apo keq, në vendet e tjera edhe pse me shumë vështirësi dikush hynte, ndërsa këtu jo. Pra ishte krejt e mbyllur. Me pak fjalë u leverdiste të gjithëve të thoshin...

Nuk krijonte probleme. Ndryshe nga Gedafi nuk hidhte në erë avionë...

Jo, nuk ndodhte asgjë. Ishte një problem...

Për popullin e tij.

E saktë. Meqenëse siç e thashë, politika ndërkombëtare është shumë cinike, nëse ekziston një popull që vuan më keq për të. Kjo është diçka shumë e dhimbshme, por... Mbyllja e regjimit shqiptar ishte vërtet e tmerrshme. Për më shumë se dy vjet u përpoqa... Unë s'do të kisha ardhur këtu si revolucionar, sepse s'do të isha në gjendje ta bëja. Do të vija për të treguar çfarë ishte Shqipëria. Për këtë kishin frikë. Sepse mjaftonte të shikoje, për të kuptuar. Mjaftonte të shikoje, s'do të hynin në punë fjalët, mjaftonin pamjet. Do të kishin parë që në zemër të Evropës, dy orë larg me varkë nga Italia, ishte një vend që komunizmi e kishte kthyer me shekuj të tërë larg. Kjo s'u pëlqente, prandaj nuk erdha.


# FLET NË BOTË ME PAK



WIND

NËSE KE CELULAR ME SKEDË RIMBUSHËSE, ME 5 EURO NË MUAJ MUND TË TELEFONOSH NË ITALI NGA JASHTË SAJ DHE TË MARRËSH TELEFONATA ME VETËM 15 QINDARKA NË MINUTË, PAS MINUTËS SË PARË TË BISEDËS. PËR TË AKTIVIZUAR **EASY ROAMING** DËRGO NJË SMS NË NUMRIN FALAS 4033 ME TEKSTIN EASY ROAMING SI

PËR INFORMACIONE [WWW.WIND.IT](http://WWW.WIND.IT)





# fluturimi i **BERNARDIT**

Quhet Bernard Shehu një ndër balerinët e skenave galante që nuk ndriçohen nga prozhektorët e studiove televizive, por që nuk e nderojnë më pak baletin shqiptar. Ai është një i ri shqiptar, njëzeteshtatë vjeçar që ka mbërritur në Itali për të bërë balet, atë lloj baleti që nuk gjendet e që mezi gjendet në Shqipërinë e dikurshme dhe të sotshme. Pas një rrugëtimi të gjatë që prej vitit 2000, sot jeton në Romë dhe është pjesë e kompanisë Balletto di Roma së bashku me të tjerë balerinë shqiptarë që me të ndajnë të njëjtën kombësi e të njëjtën histori jete.

Në botën e baletit ka hyrë pa

pritur, në mënyrë instiktive e pothuaj naive, disi pa dashur, pa asnjë lloj përlllogaritjeje apo ëndrre të kulturës pop televizive, siç mund të mendohej rëndom sot. Por ka hyrë në një mënyrë shumë shqiptare, nëpërmjet një pjese të rëndësishme të kulturës shqiptare që shënon ritmet e festimeve shoqërore dhe riteve që caktojnë jetën e shqiptarëve. Skenat e tij të para kanë qenë si për shumë kolegë të tij po aq të talentuar sheshet midis tavolinave të dendura me meze, nën tingujt e sazeve dhe lashtësisë muzikore kombëtare, pikërisht dasmave të shumta që kanë një funksion socio-antropologjik në kulturën shqiptare shumë më

Quhet Bernard Shehu një ndër balerinët e skenave galante që nuk ndriçohen nga prozhektorët e studiove televizive, por që nuk e nderojnë më pak baletin shqiptar. Ai është një i ri shqiptar, njëzeteshtatë vjeçar që ka mbërritur në Itali për të bërë balet, atë lloj baleti që nuk gjendet e që mezi gjendet në Shqipërinë e dikurshme dhe të sotshme.

tepër se kudo tjetër. Dhe prej andej, djaloshi që dinte të valëzonte në mënyrë spontane por të goditur u ngjit në skenat më të famshme shqiptare, italiane e ndërkombëtare.

Kjo duke kaluar më parë natyrisht nëpër palestrat e rrepta të Akademisë së Tiranës, ku shija dhe disiplina sovjetike diti të mburrë talentin për atë që balerini shqiptar do të ishte në të ardhmen. Ka qenë vendimtare gjurma sovjetike që e ka shoqëruar edhe në Azerbajxhanin e largët - një vend i çuditshëm, të cilit shqiptarët vështirë t'i njohin më shumë se


# FLUTURIMI I BERNARDIT

vijon nga faqja 13

sa emrin e çuditshëm, që përzihet me reminishenca malesh, luftë të ftohtë e valle të përfytyruara kozakësh. Kjo sepse Baku, dhe Tirana janë binjakë sovjetikë të të njëjtës traditë, dhe të dyja janë po ashtu tmerrsisht të lidhura me traditën e vet kulturore që bën që emrat e kompanive të vallëzimit me origjinë prej tyre të radhiten në top-listat e performancave ndërkombëtare me përpikëri absolute. Nuk është kjo asgjë e re. Të njëjtat faza të formimit profesional i kanë kaluar edhe të tjerë kolegë të tij që kanë shëtitur shtypin italian duke mbajtur lart zërin e akademisë së Tiranës. Mirëpo Baku dhe Tirana, dy simotra sovjetike mbeten besnike të traditës klasike që jep një shtysë të mirë teknike por nuk lejon shpalosjen e krijueshmërisë që baleti bashkëkohor ka mbërritur prej kohësh në perëndim. Dhe si shumë të tjerë, etapa për të mbërritur që lindja nuk ofron edhe Bernardit iu desh në mënyrë shumë spontane të nisej drejt portit perëndimor më të afërt për të mbetur aty, me sodisfaksion.

Italia i ka hapur kështu dyert e artit bashkëkohor, më parë në veri e më pas prej disa sezonesh edhe në kompaninë prestigjioze në Romë, Balletto di Roma. Projekti më i afërt është Otello, ku Shehu do të ketë një rol prej solisti, ndërsa firma do të mbahet nga askush më pak se sa koreografi Fabrizio Monteverde.

Por ka edhe projekte të largëta, të lidhura me të tashmen dhe një të ardhme më të mirë, me Italinë e me Shqipërinë. Shehu është një balerin i brezit të ri që për nga formimi i përket sa Shqipërisë aq edhe ambientit ndërkombëtar të baletit bashkëkohor sot ku e gjen veten me kompaninë Balletto di Roma. Dhe është një personalitet artistik i ndarë kështu mes dy kulturash baleti të cilat i njuh më së miri nga afër dhe mes të cilave mund të shërbejë si urë lidhëse për progresin e



dhe shkëmbimin e ndërsjellët të të dyjave. Mbi të gjitha ashtu si edhe kolegët e tij të njëjtit formim e me të njëjtën të kaluar ai është një resurs potencial për Tiranën artistike, nga e cila e ndan vetëm një thirrje telefonike larg, e një projekt-ide e pahedhur në letër. Ndërsa deri tani balerinët shqiptarë janë konsideruar si trofe të krenarisë kombëtare përballë dinjitetit të nëpërkëmbur të shqiptarëve nëpër botë, pas përgëzimeve për kontribute të veçanta që qarkullojnë Tiranës mondane, mbetet për tu prekur faza konstruktive, ajo e ripërvetësimit të talenteve shqiptare nga vetë arti shqiptar. Deri tani nuk ka ndodhur, por ndërsa baleti shqiptar synon të integrohet e të zhvishet nga klasicizmi i palëkundur - siç thuhet tashmë prej vitesh - edhe kjo do të vijë, dhe Bernard Shehut dhe brezit të tij do t'i takojë me siguri roli i çprovincializimit të artit shqiptar dhe modernizimit të tij. Premisat nuk mungojnë, koha më pas do të tregojë.

(ma.ru.)

## INTERVISTA

nga Marjola Rukaj

**Kur keni filluar të merreni me balet?**

Ne botën e baletit kam hyrë falë tim eti, ishte e gjitha meritë e tij, meqë në një farë mënyre ishte ai që më zbuloi. Në Shqipëri siç e dini njerëzit hyjnë në shkollën e baletit në moshën 10 vjeçare dhe në atë moshë kuptohet unë nuk kisha të tilla dëshira, nuk isha në gjendje të bëja vlerësime të kësaj natyre si gjithë moshatarët e mi normalisht në atë kohë. Babai im vendosi për të njëjtën zgjedhje edhe për motrën time, e cila edhe ajo bëri akademinë e baletit, vetëm se ne të dy nuk kemi kërcyer asnjëherë bashkë. Me përjashtim të një spektakël në Macerata, por jo në Shqipëri. Kështu lindi gjithçka. Në të vërtetë kuptohet si shumë balerinë të tjerë, palestra e zbulimit edhe për mua kanë qenë dasmat shqiptare. Ai vuri re se unë kërceja me shumë dëshirë dhe se kërceja mirë dhe prandaj mendoi se ishte rasti të provoja në këtë fushë. Ndoshta natyrisht kishte të bënte edhe me dëshirën për një jetë më të mirë, sepse kuptohet njerëzit që bëjnë një jetë prej artisti jetojnë shumë më mirë se sa shumë të tjerë. Dhe kështu nisa akademinë në Tiranë. Për dhjetë vjet kam studiuar në akademinë e Tiranës, dhe më pas kam shkuar në Azerbajxhan. Në përgjithësi njerëzve u duket çudi kur them që jam diplomuar në Azerbajxhan por arsyeja është shumë logjike. Ndodhi kështu sepse Azerbajxhani është një vend ish sovjetik dhe aty vazhdon tradita e shkollës ruse, që është e mirënjohur për cilësinë e baletit. Ndoshta nuk është më e mirë se ajo e Tiranës por është patjetër shumë e mirë. Profesori ynë ende merr nxënës të Akademisë së Tiranës për t'i çuar në atë shkollë në Azerbajxhan.

**Si ishte kjo eksperiencë, një shqiptar në Azerbajxhan?**

Ishin 12 vetë, ndër të cilët Gjentian Doda, Anbëta, Ledian Agalliu etj.. Ikëm në '97, ndërsa në Tiranë kishte luftë civile. Ne duhej të shkonim në shtator por u transferuam në maj, katër

Në botën e baletit ka hyrë pa pritur, në mënyrë instiktive e pothuaj naive, disi pa dashur, në një mënyrë shumë shqiptare, nëpërmjet një pjese të rëndësishme të kulturës shqiptare, pikërisht dasmave. Dhe prej andej, djaloshti që dinte të vallëzonte në mënyrë spontane por të goditur u ngjiti në skenat më të famshme shqiptare, italiane e ndërkombëtare.

muaj para. E kaluam verën në plazh atje, duke pritur fillimin e shkollës. Ishte një eksperiencë shumë e bukur. Dhe mbi të gjitha ishte një eksperiencë shumë e vlefshme. Sepse na formuan për tu bërë solistë. Lëndët ishin të njëjta si në akademinë e Tiranës, ndryshonte vetëm nga fakti se kishim edhe vallëzime tipike të Azerbajxhanit që ne duhej t'i mësonim. Edhe kjo ishte një gjë interesante. Janë vallëzime të ndryshme nga tonat por është interesante se ka atë forcë dhe atë sharm që përcjellin vallëzimet tona. Janë sidoqoftë vallëzime të krijuara për meshkujt. Unë kujtoj kur kemi bërë me shkollën konkurset e valleve popullore, çmimet e para i merrnin gjithmonë ose gjeorgjianët, ose azerët, ose akademia jonë e Tiranës, apo Teatri jonë i Operas, ansambli i shtetit domethënë kuptohet.

Si filloi aventura italiane?

Pasi u ktheva nga Azerbajxhani në Shqipëri, me një trupë vallesh tradicionale, shkua në provincën e Romës për një festival dhe me atë rast të tjerët u kthyen kurse unë shkova në Parma për të vazhduar

**Po tani, me sytë e këtyre viteve, mendon të qëndrosh në Itali, apo të veprosh si**

studimet.

**Po pse pikërisht zgjodhët Italianë?**

Ishte edhe për shkak të miqësive të mia, sepse për shembull shoku im i ngushtë në atë kohë, Gentian Doda ndodhej në atë kohë në Parma dhe ai më prezantoi profesorët e tij me të cilët arrita të fokusoja atë që më interesonte të bëja në Itali. Dhe kështu në vitin 2000 erdha në Itali. Ishte e natyrshme sepse nuk njihja asnjë, dhe e vetmja pikë referimi ishin këta shokë dhe këto kontakte. Nuk kisha ndonjë objektiv konkret, të shkoja në Itali, në Francë, apo në Gjermani. Isha 18 vjeç dhe isha gati të merrja çfarëdolloj mundësie. Nuk jam në gjendje të them konkretisht as pse doja patjetër të ikja e të mos qëndroja në Tiranë. Ndoshta sepse isha larguar nga Tirana që në moshën 15 vjeçe, dhe kur u ktheva kisha humbur pikat e referimit të ambientit tim, shumë gjëra kishin ndryshuar, në shkollë, në Teatrin e Operas dhe të Baletit, edhe balerinët që vallëzonin në televizion, ishin tashmë grupe të formuara. Dhe ndoshta këto kanë qenë edhe arsye pse vendosa të largohesha nga Shqipëria. Italia ishte kështu mundësia e parë që mu dha dhe që e shfrytëzoja.

**shumë kolegë të tutë, nëpërmjet Italisë të transferohesh diku tjetër?**

E ndiej veten mirë më Balletto di Roma, dhe mendoj të vazhdoj të qëndroj në Itali edhe për të ardhmen. Jo vetëm si balerin, por më pëlqen shumë edhe të jap mësim. Ndoshta hapja e ndonjë shkolle do të ishte një variant. Këto janë gjëra që do të vijnë më vonë. Sidoqoftë nuk e ndiej të nevojshme të largohem nga Italia.

**Çfarë mendon se të ka dhënë Italia, që ndoshta në Tiranë nuk**

**do të gjeje?**

Edhe në Azerbajxhan shkolle që ne ndoqëm ishte e të njëjtës traditë sovjetike si shkolla e Tiranës, ndërsa Italia më ka dhënë baletin bashkëkohor, baletin modern. Tek ne kjo ka filluar të hyjë por ende nuk është e trajtuar mirë, mungojnë aftësitë për tu marrë me baletin bashkëkohor. Sot baleti klasik nuk mjafton. Patjetër nevojitet edhe puna me baletin klasik sepse është diçka që të jep shumë si bazë edhe për baletin bashkëkohor, mirëpo kjo nuk mjafton. Për të hyrë dhe për të bërë pjesë në një kompani baleti sot nuk mjafton vetëm baleti

E ndiej veten mirë më Balletto di Roma, dhe mendoj të vazhdoj të qëndroj në Itali edhe për të ardhmen. Jo vetëm si balerin, por më pëlqen shumë edhe të jap mësim. Ndoshta hapja e ndonjë shkolle do të ishte një variant. Këto janë gjëra që do të vijnë më vonë. Sidoqoftë nuk e ndiej të nevojshme të largohem nga Italia.

klasik, nevojitet patjetër edhe baleti bashkëkohor. Janë shumë të pakta kompanitë që kryejnë vetëm balet klasik dhe bëhet fjalë për institucione të mëdha si La Scala, apo si Opera e Romës, dhe të tjera që gjenden në kryeqytete të rëndësishme, por është e vështirë të mbahet një kompani vetëm me këto.

**The që këto elemente nuk ekzistojnë ende në shkollën e Tiranës. Nga se vjen kjo? Kanë kaluar tashmë pothuaj 20 vjet nga hapja e Shqipërisë me botën?**

Sipas meje, gjëja kryesore që mungon jemi pikërisht ne, ne balerinët që jemi nëpër botë. Do të duhej që ne të ktheheshim dhe të vinim në praktikë eksperiencën tonë. Atë që kemi mësuar ne në Spanjë, në Itali, në Gjermani, në Francë. Por nuk kthehemi sepse duhet të kemi edhe mbështetjen e teatrit të operas. Një prej ëndrrave të mia është të organizoja një mbrëmje gala me disa prej balerinëve që janë sot nëpër botë. Disa prej tyre janë kthyer herë pas here për të marrë pjesë në ndonjë spektakël por asgjë më shumë se kaq. Pjesa më e madhe e tyre janë larguar prej më shumë se 10 vjetësh duke vallëzuar kudo përveç se në skenën e teatrit të Operas dhe Baletit të Tiranës. Kjo do të ishte një gjë shumë pozitive edhe për shkollën. Sipas meje mungon kultura dhe mungon

vijon në faqen 16



vijon nga faqja 15

## FLUTURIMI I BERNARDIT

eksperienca e baletit bashkëkohor. Mungojnë natyrisht edhe mësuesit. Kur ne erdhëm këtu, në Tiranë ekzistonte vetëm baleti klasik. Di që diçka është duke lëvizur. Duhet marrë mësues nga jashtë, të bëjnë stazhe, tu jepet mundësia për të përgatitur spektakle edhe gjëra të vogla, me grupe s'është e thënë të bëjnë gjëra gjigante prej 40 balerinësh, e spektakle të gjata madhështore, mjafton shumë më pak. Por janë gjëra që duhen bërë. Nga ana tjetër nuk jam në gjendje ta shpjegoj qartë se çfarë mungon. Ndoshta vullneti por edhe për këtë nuk jam i sigurt, paratë nuk besoj se mungojnë të paktën nga sa kam parë, më duket se fondet janë. Në fund të fundit nuk jam në gjendje të them se çfarë mungon sepse duke mos jetuar në Shqipëri e kam të vështirë tu hyj gjërave kaq thellë.


**Pra ka një "ikje truri" në baletin shqiptar...**

Ne nuk kthehemi sepse është normale që kur jeton në një vend tjetër për 10 vjet është shumë e vështirë të kthehesh prapa. Nuk e dimë nga t'ia nisim po të kthehemi. Duhet të kemi edhe një mbështetje kur kthehemi. Nuk mund të kthehemi pa pasur të qartë se çdo të bëjmë atje. Pa pasur kontakte. Kur nuk ke kontakte e ke të vështirë. Jemi shumë balerinë shqiptarë nëpër botë. Mund të vemi të marrim pjesë, të japim ndonjë ide, për shkëmbim, për pasurim eksperiencash. Ne kthehemi të gjithë në gusht për pushime, por në gusht nuk mbetet asgjë. Por ne duam të kthehemi kjo është në gjë që kam vënë re tek shumë prej nesh. Disa kanë pikërisht dëshirën të japin mësim në akademinë e Tiranës për shembull, apo sidoqoftë të vënë në praktikë në dobi të baletit shqiptar eksperiencën e tyre.

**Të krijohet përshtypja se në Shqipëri për balerinët, kujtohen në gusht gjatë pushimeve, "Ja balerini që na nderon jashtë shtetit" dhe pastaj gjithçka harrohet...**

Po është kështu. Nuk u kush-ton asgjë të ngrenë telefonin dhe të na propozojnë. Nuk besoj se dikush prej nesh do të thonte "jo nuk mundem". Ndër balerinët që njoh unë këtu, të gjithë do të ishin të gatshëm pa e menduar gjatë të niseshin dhe të organizonin diçka duke bashkëpunuar edhe me miqtë tanë që vazhdojnë të jetojnë në Shqipëri. Nuk do të ishte një ide e keqe.

**Por ka pasur tentativa për të tilla përvoja?**



”

Erdha me idenë për të punuar e për t'u përmirësuar. E gjeta veten mirë. Nuk mendoj se ka ndonjë specifikë të veçantë të qenët shqiptar. Të jesh shqiptar ndoshta është njësoj si të jesh francez, apo anglez, apo gjerman, tashmë në balet. Është e gjitha meritë e atyre balerinëve që hynë të parët në këtë sferë, si Anbeta, Kledi, Iliri



Jo unë personalisht nuk kam tentuar, por kam këtë ide prej të paktën një viti. Shpresoj që në pushimet e ardhshme në Tiranë të arrij të kontaktoj njerëzit e duhur për të organizuar diçka prej vërteti.

**E ndjek baletin shqiptar ndërkohë?**

Po. Mendoj se shkolla mbetet një shkollë cilësore. Edhe se në këtë drejtim ka pasur një ndryshim brezash. Ka disa miq të mitë që kanë filluar të japin mësim në shkollë. Në fakt është një gjë pozitive. është diçka që i nevojitet shkollës, kuptohet kjo gjë dihej dhe e thonin të gjithë. Por sipas meje nuk duhet të ishte një gjë kaq drastike. Mendoj që kjo do të sjellë gjëra pozitive. Bëhet fjalë për njerëz që angazhohen, që përpiqen shumë, por më duket se tani ka filluar të mungojë disi disiplina. Shkova vitin e kaluar për të parë disa leksione, dhe kjo ishte përshtypja që më mbeti. Ne kishim rregulla më të rrepta për respektimin e disiplinës, për respektimin e mësuesve, kodin e sjelljes etj. Por ndoshta kjo nuk ndodh për faj të të rinjve që kanë ardhur aty këto vitet e fundit. Vetëm se në këtë drejtim nuk do të ishte keq që ndonjë mësues i huaj të merrte pjesë herë pas here për të shkëmbyer eksperiencë. Do të ishte diçka shumë pozitive. Por edhe në këtë rast mungon ajo që thojnë më parë. Jo paratë, ndoshta vullneti, nuk di të them.

**Pra Shqipëria mbetet një vend i izoluar?**

Jo nuk më duket kështu. Ka bashkëpunime. Di për shembull për bashkëpunime me disa koreografë italianë, që kanë bashkëpunuar me Teatrin e Operas dhe Baletit. Kjo është natyrisht pozitive, por nuk mjafton. Dua të them duhet të jetë diçka e vazhdueshme. Nuk mjafton një spektakël apo dy, duhet të ketë një shkëmbim të vazhdueshëm që ka të bëjë me didaktikën më tepër, se sa me spektakle të izoluar. Duhet të rrisin stazhet, konkurset, ashtu siç bëhet këtu në Itali. Është e vërtetë që në Itali për shembull për çdo fshat të vogël ka disa shkolla baleti, ne kemi vetëm një, dhe ajo duhet mirëmbajtur, prandaj ndoshta ka edhe këtë prestigj që ka. Meqenëse nuk na lënë të hyjmë në Bashkimin Evropian duhet të gjejmë mënyra bashkëpunimi institucionale të tilla për të dalë nga izolimi kulturor.

**Po thojë që të pëlqen mësimdhënia, do ta shihje veten në**



Vetëm **15 cent.€/min**  
për të telefonuar në **Shqipëri.**  
Atdheu yt nuk ka qenë kurrë  
**kaq afër.**



Aktivizo menjëherë No Distance  
dhe telefono në Shqipëri me 15 cent.€/min.



 Store | [www.tre.it](http://www.tre.it)

199 100 700

SHKREHJA E PËRGJIGJES 16 CENT.€, TARIFIMI VETËM MBI SEKONDAT EFEKTIVE TË BISEDËS. OPSIONI NO DISTANCE AKTIVIZOHET ME 0€ PËR 30 DITË E PARA NËSE NËNSHKRUHET GJATË FAZËS SË AKTIVIZIMIT TË NJË SKEDË RIMBUSHËSE 3. NË SKADIM PARASHIKOHET PËRTËRITJA AUTOMATIKE PËR 30 DITË KUNDREJT KOSTOS SË 5€. OPSIONI 1 VLEFSHËM VETËM NË ITALI NËN MBULIMIN KOMBËTAR TË 3, PËR PERIUDHËN E AKTIVIZIMIT, DHE JO I PAJTUESHËM ME PLANIN RIMBUSHËS SUPER O MONDO, ME OPSIONIN INTERNATIONAL 3 DHE ME PLANET E ABONIMIT. PËR INFORMACIONE MBI MBULIMIN, KUSHTET DHE KOSTOT [WWW.TRE.IT](http://WWW.TRE.IT) OSE 3 STORE.

abonohu në

# Bota shqiptare

GAZETA E SHQIPTARËVE NË ITALI

fituese e çmimit m.souhir 2005 të gazetarisë italiane si "gazeta më e mirë për të huajt në itali"

"Bota shqiptare" është prej dhjetë vitesh i vetmi zë në gjuhën shqipe në shtypin italian.

"Bota shqiptare" botohet nga e vetmja shtëpi botuese në gjuhën shqipe në Itali

"Bota shqiptare" nuk ka përfituar e nuk përfiton asnjë kontribut financiar publik italian apo shqiptar.

"Bota shqiptare" është e pavarur dhe jeton vetëm sajë shitjeve, abonimeve dhe reklamave

**PAJTOHU PËR VETE**

apo për t'ia bërë dhuratë një miku

abonimi për një vit (22 numra)

**€ 35.00**

ABONIMI MUND TË FILLOJË NË ÇDO PERIUDHË TË VITIT  
PAGESA KRYHET PRANË ÇDO SPORTELI TË POSTAVE ITALIANE  
nëpërmjet derdhjes së një buletini postar pagese  
në llogarinë postare (conto corrente postale)  
nr. 16831018 në favor të BOTA SHQIPTARE

Telefono në redaksi dhe kërko të të nisim numrin e parë bashkë me fletën e abonimit të plotësuar.  
Me ta marrë, të mbetet veç të shkosh në postë për të paguar.

Kursen 20% nga çmimi në  
pikëshijet e gazetave  
- Gazeta të mbërrin drejt e në  
shtëpi pa asnjë shpenzim  
të mëtejshëm

BOTA SHQIPTARE, VIALE MARCO POLO 119, 00154 ROMA

REDAKSIA DHE SHËRBIMI I ABONIMEVE TEL 06-57289240 - FAX 06-62209543 - CEL. 339-6426836

redaksia@botashqiptare.net

# FLUTURIMI I BERNARDIT

vijon nga faqja 17

## Akademinë e Tiranës?

Po më pëlqen mësimdhënia dhe mendoj se nj balerin shqiptar që ka kërcyer për më shumë se gjashtë sezone në skenat italiane, është në gjendje të japë shumë për Akademinë e Tiranës. Por në këtë drejtim do të privilegjoja kuptohet baletin modern sepse është ky ai në të cilin unë mund të jepja më shumë dhe që në të vërtetë në Shqipëri ka nevojë. Do të më pëlqente për shembull nëse biem dakord disa prej nesh për të hapur një shkollë së bashku në Tiranë. Ndërsa vetëm është e vështirë të imagjinoj diçka të tillë.

## Pra ngelesh i lidhur me Shqipërinë?

Po pa tjetër. Është vendi im. Atje kam prindërit dhe vëllanë. Patjetër që jam i lidhur. Projektet e mia kanë të bëjnë qoftë me Italinë qoftë me Shqipërinë. Nëse në të ardhmen arrihet të ndërtohet diçka e përbashkët do të ishte idealja.

## Si e shpjegon faktin që ka kaq shumë inflacion balerinësh nga Akademia e Tiranës? Është ndoshta çështje kulturore e shqiptarëve në përgjithësi?


Është një pyetje që na e bëjnë në përgjithësi shumë gazetarë italianë. Sepse ishte dhe është një shkollë serioze, me një bazë të admirueshme. Çelësi i suksesit është ky. Këtu ka një mori shkollash baleti, ndoshta për një krahinë prej pak milionësh ka 30 shkolla baleti, kurse ne për tre milionë shqiptarë kemi vetëm një. Kështu kur dikush hyn në atë shkollë për të studiuar hyn për tu bërë profesionist. Sepse natyrisht nuk je në gjendje të bësh asgjë tjetër. Nuk mund të bësh baletin duke studiuar balet një apo dy herë në javë siç mendojnë në Itali. Duhet një përkushtim dhe një disiplinë e jashtëzakonshme. Kjo është ajo që ofron kjo shkollë. Jep një bazë të fuqishme për baletin klasik.

Po ndoshta është një arsye kulturore? Shpesh balerinët shqiptarë e zbulojnë veten duke kërcyer muzikë folkloristike. Ka peshë në këtë prirje edhe kjo rëndësi që i jep kultura shqiptare vallëzimit?

Pa tjetër, në fakt unë dëgjoj



Këtu ka një mori shkollash baleti, ndoshta për një krahinë prej pak milionësh ka 30 shkolla baleti, kurse ne për tre milionë shqiptarë kemi vetëm një. Kështu kur dikush hyn në atë shkollë për të studiuar hyn për tu bërë profesionist. Sepse natyrisht nuk je në gjendje të bësh asgjë tjetër. Nuk mund të bësh baletin duke studiuar balet një apo dy herë në javë siç mendojnë në Itali. Duhet një përkushtim dhe një disiplinë e jashtëzakonshme. Kjo është ajo që ofron kjo shkollë.



shumë muzikë shqiptare folkloristike, të kërcyeshme. Dhe shpesh herë ua lë ta dëgjojnë edhe miqtë e mi italianë. Është një pjesë e jona shumë e rëndësishme që e marrim me vete dhe që ia vlen ta përhapin edhe në vendet ku jetojmë në mënyrë që të njohin kulturën e vërtetë shqiptare, kulturën e njerëzve. Ndryshe nga ato që mendojnë pas viteve '90. Kemi tradita dhe një kulturë që reflektohet shumë bukur në muzikën tonë. Miqtë e mi italianë e pëlqejnë dhe e dëgjojnë. Kanë ardhur në Tiranë, kanë parë këtë lloj kulture.

## Si e ke ndier veten si shqiptar në Itali?

Unë jam ndier shumë mirë, që në fillim. Më kanë respektuar dhe i kam respektuar të gjithë. Nuk më mbetet veç të jem mirënjohës. Më është dhënë ajo që kam merituar. Personalisht përveç kuesturës dhe proble-

meve që dihet, për lejen e qëndrimit, nuk kam pasur asnjë lloj problemi tjetër, as me kolegët as në përgjithësi në shoqërinë italiane.

## Pra të jesh balerin shqiptar sot në Itali ka një ngjyrim të veçantë apo është njësoj si të jesh një balerin kozmopolit që jeton në këtë vend?

Është një gjë pozitive. Natyrisht gjithçka që ka të bëjë me emrin dhe me suksesin është meritë e punës dhe përkushtimit. Unë nuk u zhgënjeva ndoshta edhe sepse kur erdha nuk kisha iluzione për suksese të lehta. Erdha me idenë për të punuar e për tu përmirësuar. E gjeta veten mirë. Nuk mendoj se ka ndonjë specifikë të veçantë të qenët shqiptar. Të jesh shqiptar ndoshta është njësoj si të jesh francez, apo anglez, apo gjerman, tashmë në balet.

## Është përmirësuar shumë imazhi me pak fjalë?

Po pa tjetër, është e gjitha meritë e atyre balerinëve që hynë të parët në këtë sferë, si Anbeta, Kledi, Iliri, etj.

## Ndërsa ti, përse nuk u bërë pjesë e "Amici"-t?

Po është vështirë ta thuash. Ka një moment të duhur për gjithçka. Ndoshta sepse unë erdha me të tjera objektiva, dhe e gjeta menjëherë rrugën që do të merrja. Ndoshta ngaqë isha i zënë nuk mund të shikoja të tjera mundësi. Nuk e kërkova një mundësi të tillë. Pastaj u angazhova me kompani të mira, me një kontratë të mirë, dhe nuk mendoja se më duhej një gjë e tillë.

Bisedoi Marjola Rukaj

# KLEDI KADIU

fitues i çmimit Elsa Morante - Ragazzi. Kësaj radhe si shkrimtar, për librin e tij "Meglio di una favola"

Balerin, aktor e së fundi edhe shkrimtar. Madje jo dosido por me dhjetra mijëra kopje të shitura e, qershia mbi tortë, një çmim i rëndësishëm letrar italian, Elsa Morante, për gjininë e të rinjve. Nuk ndalet Kledi Kadiu i cili, për më shumë, di të përdorë vizibilitetin që i lejon media për t'u dhënë zë shqetësimeve të emigrantëve. Në këtë intervistë të botuar njëkohësisht në italisht në Metropoli të La Repubblica-s, Kadiu flet si një ambasador i vërtetë i tërë të huajve në Itali

**Të jesh klandestin do të përbëjë vepër penale. Ç'mendim ke?**

Mendoj se është budallallëk, sepse edhe klandestinët janë para së gjithash persona dhe u duhet lejuar ruajtja e dinjitetit. Fakti i të mos qenit në rregull me dokumentet e qëndrimit nuk e kthen një njeri në keqbërës. Edhe unë kam ardhur në Itali në rrugë të paligjshme. Pas pak u ktheva në Shqipëri për t'u rikthyer këtu me vizë për studime. Fillova të punoja e kështu mora dokumente qëndrimi.

**Si e sheh ashpërsimin e normave mbi emigracionin?**

Jam dakord me testin e gjuhës italiane, është e drejtë që kush dëshiron të jetojë e të punojë në një vend tjetër të njohë gjuhën. Ndërsa më duken shumë të rënda pengesat e ngritura për bashkimet familjare, martesat dhe ideja e patrullimeve (ronde). Gjëra të tilla i fryjnë flakëve të dhunës dhe urrejtjes mes personave. Nuk arrij të kuptoj përse emigranti, edhe kur është i rregullt, duhet të nëpërkëmbet e të poshtërohet rregullisht. Më pranon në këtë vend por nuk më jep barazinë me italianët. Mos vlej më pak? Është personi që bën diçka dhe jo pasaporta e tij. Ligji duhet të jetë i ashpër me ata që përdhunojnë e vrasin, por në këtë nuk hyn aspak prejardhja. Sot emigrant do të thotë frikë, rezik publik. Nuk arrij të mbarosh fjalinë "jam rumun", "jam maroken", dhe të përplasen dyert në fytirë. Ky dallim vërehet edhe mes fëmijëve dhe kjo është një gjë shumë e rëndë. Për këtë situatë, kanë përgjegjësi edhe mediat, që ushqejnë njerëzit vetëm me lajme negative, në të cilat sa më shumë të citosh shqiptarë e afrikanë



”

Jam italian prej një viti, por nuk dua t'ia di për shtetësinë italiane, jam krenar që jam shqiptar. E kërkova shtetësinë vetëm për të qenë më i lirë për të lëvizur e për t'iu shmangur formaliteteve burokratike poshtëruese që duhen bërë për dokumentet. Kur je jokomunitar, në skanerët e aeroportëve bashkë me valixhet kalon edhe shpirti yt.

aq më shumë bujë bëjnë".

**Kohët e fundit duket se është rënduar klima e intolerancës...**

Populli italian në vetvete nuk është racist. Fajin për këtë atmosferë e ka injoranca e atyre që kanë pushtetin dhe propozojnë ligje të caktuara. Ka dy tre të çmendur që kanë komandën në dorë e dalin me ide që nuk qëndrojnë as në qiell e s në tokë, si për shembull, ideja e rezervimit të vagonëve të metropolitane vetëm për milanezë. Duket sikur jemi kthyer në kohët e aparteidit.



Nga lart, shkrimtarja e njohur Dacia Maraini i dorëzon Kledi Kadiut çmimin "Elsa Morante - Ragazzi". dhe kopertina e librit botuar nga Mondadori.

Shumë gjyshët të bashkëmohatarëve të mi italianë kanë emigruar në Amerikë dhe e di që atje nuk e kanë pasur të lehtë. Historia nuk duhet të përsëritet, duhet reflektuar e ndryshuar. Nga një anë flitet shumë për integrim, për Bashkimin Europian, për kufij të hapur e nga ana tjetër jemi dëshmitarë ligësisht e absurditetesh.

**Udhëtimi yt i parë për në Itali u ngjan atyre të afrikanëve sot. Ç'mendon për dramën e tyre?**

Kam përjetuar një eksperiencë të ng-

jashme arrij të vihem në vendin e tyre, por situata kaq të dhimbshme nuk mund të shpjegohen me fjalë. Këta njerëz vënë në rrezik jetën e vet e kjo nuk kuptohet deri në fund nga të tjerët. Nuk them që u duhet dhënë të gjithëve pa dallim një mundësi, por duhet gjuar pasi këta njerëz të njihen e kuptohen, sepse çdo person është ndryshe e ka një histori ndryshe pas krahëve që duhet konsideruar.

**Të konsideron ende ndokush emigrant?**

Mund të jesh me ngjyrë, shqiptar, rumun, por kur ke sukses për njerëzit nuk je më emigrant. Sot asnjë nuk më kujton me të keq origjinën time, por nuk është e drejtë që të jetë suksesi që të sjellë këtë. Një njeri i mirë, edhe pse jo i famshëm, meriton të njëjtin respekt pavarësisht nga kombësia e tij. Kurioziteti për të njohur tjetrin është një akt që flet shumë për kulturën e një populli. Por këtu nuk e shoh këtë kuriozitet, mbretërojnë thashethemet. Ka një mentalitet të mbyllur dhe mungon kultura e përgjithshme: dikush më tha që kryeqyteti i Rumanisë është Sofia!!!

**Ke pasaportën italiane?**

Po, prej një viti, por nuk dua t'ia di për shtetësinë italiane, jam krenar që jam shqiptar. E kërkova shtetësinë vetëm për të qenë më i lirë për të lëvizur e për t'iu shmangur formaliteteve burokratike poshtëruese që duhen bërë për dokumentet. Kur je jokomunitar, në skanerët e aeroportëve bashkë me valixhet kalon edhe shpirti yt.

**Italia dhe Shqipëria...**

Shqipëria është atdheu im, herë pas herë kthehem. Ndihej para së gjithash shqiptar, por e gjithë jeta ime, puna, miqtë, janë këtu. Tani jam beqar, është e vështirë të gesh një person që arrij të bashkëjetojë me zanatin tim. Shtëpia ime është Italia, dhe më ka dhënë shumë.

**Një rrugë e gjitha në të përpjetë e jotja?**

Në Shqipëri shteti i jepte përparësi atij që dëshironte t'i dedikojë sportit apo artit. Mund të kultivonim një disiplinë falas me mësuesit më të mirë, por duhet të jepnim maksimumin. Formimi i shkëlqyer që kisha mbi shpatulla, bashkë me këmbënguljen, disiplinën dhe talentin, më hapën dyert. Asgjë nuk është e pamundur, por mbi skenë duhet të tregosh aftësinë që ke, nuk mund të jetosh me fjalë e letrat e diplomave. Për mua vallëzimi është sakrificë, heqje dorë nga të tjera gjëra, por mbi të gjitha është pasion. Receta e suksesit është të dashurohesh me atë që bën, ta kthesh në arsyen e jetës, jo vetëm të punës. Të përjetosh çdo eksperiencë si unike pa menduar për strategji për të arritur suksesin. Padyshim, fati ka luajtur rolin e tij, por nëse investon talent, vendosmëri e besnikëri, herët a vonë shpërblehesh.

Bisedoi Antonia Ilinova

“Merr hak” balerina shqiptare, e cila triumfon në garën e talenteve të “Amici” duke fituar kupën si artistja më e mira e të gjitha edicioneve. Në edicionin ku kish qenë konkurrese kishte dalë e dyta por tashmë është i vetmi personazh i dalë nga Amici që ka arritur majat e profesionalizmit dhe suksesit



**P**as tri orëve spektakël të nivelit të lartë mes 12 të rinjsh, shumë prej të cilëve talente të mirëfillta, mbrëmja televizive e Canale5 e 15 qershorit, e titulluar "Sfida e Talenteve", kurorëzohet me shpalljen fituese të Anbeta Toromanit.

Pjesëmarrësit janë gjashtë këngëtarë e gjashtë balerinë pjesëmarrës në edicione të ndryshme të shkollës-spektakël "Amici", ndërsa juria që vlerësoi paraqitjen e tyre përbëhej nga ekspertë të muzikës e baletit, dhe gazetarë.

Pas disa sfidave dyshe, në finale arrijnë Anbeta dhe Karima (fituese e vendit të tretë në edicionin e gjashtë të "Amici-t"). Garën e fiton Anbeta bashkë me 50 mijë eurot që i takojnë fitimtarit të spektaklit.

Toromani, balerinë klasike, u bë menjëherë e njohur për publikun e gjerë italian pas konkurrimit në edicionin e dytë të "Amici", ku u rendit e dyta. Spikati menjëherë mbi të gjithë të tjerët për zotësinë dhe talentin e saj të

jashtëzakonshëm. Në fakt, Anbeta deri në çastin kur erdhi në Itali për të konkurruar në "Amici", ishte balerinë e parë e Teatrit të Operës dhe Baletit në Tiranë. Pas konkurrimit ajo u mbajt nga "Amici" ku edhe sot është pjesë e trupës së profesionistëve të spektaklit. Mes arritjeve të ndryshme të Anbetës gjatë këtyre viteve në Itali, përveç spektakleve televizive të Maria De Filippit, mund të përmendim çmimin Gino Tani (2004) për artet e spektaklit dhe çmimin Danza&Danza (2005), pjesëmarrja në operën Makbethi i Giuseppe Verdit, në rolin e perëndeshës së shtrigave.


Mes pjesëmarrësve në spektaklin "Sfida e Talenteve" ishte edhe Leon Cino, fitues i edicionit të tretë të "Amici-t". Bashkë me Anbetën e Kledin, edhe ai është një nga fytyrat e njohura të spektakleve televizive të De Filippit dhe ka marrë pjesë në musical-at "Footloose" dhe "Io ballo"

**SuperEnalotto**

**Është më kollaj të fitosh në SuperEnalotto se sa të lindësh me fat.**

Fati është njësoj për të gjithë. Mjafton të luash SuperEnalotto, çdo të martë, të enjte e të shtunë. Mos prit më, kërkoje fatin tënd në të gjitha lokalet Sisal (ricevitoria) ku luhet lotaria.

Luaj sot. Bëhu milioner.



## Hëna e Mimosës

Një vëllim poetik nga veprimtarja shqiptare e shoqatave në Ancona

Mimoza Hametaj, poete, piktoresh dhe veprimtare e shoqatave, ka nxjerrë së fundi një vëllim të ri me poezi të titulluar "Unë dhe hëna".

Mimoza emigroi në Itali në vitin 1991. Jeton në Ancona, që i ngjet shumë Vlorës së saj. Mimoza në Itali është diplomuar në ndërmjetësim kulturor, dhe punon në fushën e emigracionit. Në vitin 2000 u bë iniciatore dhe njëkohësisht u zgjodh Presidente e shoqatës "Qytetarë të Botës". Po ashtu është një aktiviste e Lidhjes Shqiptare në Botë. Aktivitetin poetik e letrar e ka nisur që herët si recituese e poezisë së krijuar po prej vetë saj.

Sipas Mimosës gjetja e një këndvështrimi origjinal për të parë në thellësi të shpirtit është parësore. Nxjerrja prej andej dhe vënia në pah e dashurisë është përjetësimi i jetës ashtu siç bën gjeologu që nxjerr nga nëntoka arin e përjetshëm duke flakur baltën e përkohshme. Balta për Mimosën është lëndë, është trup dhe formë të cilat ndryshojnë shpesh. Një bionde shumë kollaj bëhet një ezmere dhe anasjelltas ndërsa shpirtin nuk e ndërton dot asnjëri.

Vëllimi poetik "Unë dhe Hëna" i poetes Mimoza Hametaj, gërshetohet nga një kolorit i pasur figurativ që shtrihet nga toka në hënë. Figurat e përdorura janë qendrore dhe të gjitha në funksion të shpirtit dhe dashurisë njerëzore. Poetja nuk merret me natyrën por me shpirtin prandaj, natyrën e përdor vetëm si mbulesë dhe zbulim të shpirtit. Poezinë e saj e zbulon edhe më shumë dashuria shpirtërore e saj për njerëzit, veçanërisht për familjarët, të dashurin, miqtë dhe qiellin.

Vëllimi me poezi "Unë dhe Hëna" është botuar nga shtëpia botuese Toena dhe kushton 4 euro. Kush dëshiron të blejë librin mund t'i drejtohet drejtpërdrejt autores në numrin 348 0982727 ose në mimozahametaj@yahoo.it



### Arjola Hekurani

**A**saj ngaherë i kanë interesuar gjendjet ekstreme emocionale nëpër të cilat kalon një qenie njerëzore, ndaj edhe ka zgjedhur që në një aktivitet të rëndësishëm, siç është Bienalja e Venecias, të përfaqësojë veten dhe vendin e saj me një video-instalacion që përfshin këto emocione. "Kërkuesit e emocioneve ekstreme", (Sensation Seekers") titullohet vepra e artistes Venera Kastrati, e cila ka lindur si një vëzhgim i personave që praktikojnë sporte ekstreme dhe si analizë e projektimit psikologjik të dëshirës e nevojës të çdokujt për të kaluar çdo lloj kufiri, moral apo fizik. Frymëzuar nga një ngjarje e vërtetë, ajo ka rrëfyer nëpërmjet artit të saj se deri ku mund shkojë një njeri për të arritur një qëllim e ç'mënyra mund të përdorë për ta realizuar atë. Venera Kastrati merr pjesë në Bienalen e Venecias, hapur më 7 qershor së bashku me një grup artistësh shqiptarë. Robert Aliaj Drago, Artan Shabani, Eliza Hoxha dhe Klodian Deda janë pjesë e projektit të pavarur "Krosing" që përfaqësojnë Shqipërinë në një prej aktiviteteve më të rëndësishme ndërkombëtare kushtuar artit.

Së bashku me një grup artistësh të tjerë shqiptarë, ju merrni pjesë në Bienalen e Venecias, në një takim të rëndësishëm të arteve. Si ndiheni?

Është një përgjegjësi shumë e madhe. Pjesëmarrja ime në eventin e Binales, "Krosing" është ekspozim në një projekt personal. Tani jam në fazat finale të përgatitjeve dhe emocionet janë të forta. Është diçka magjepsëse të shikosh projektin që deri dje ishte në vizatim vetëm i hedhur në letër, i skicuar, të ndërtohet realisht.

Si e vlerësoni ju Bienalen e Venecias? Ç'është për ju ky eveniment?

Bienalja e Venecias është institucioni më vjetër ekspozues ndërkombëtar në botë, duke shënuar edicionin e tij të parë pikërisht në vitin 1895, edhe pse periudha e artë e Binales arrin pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1968. Sot, përveç Venecias janë shtuar edhe shumë manifestime bienaleje, si p.sh. në San Paolo, Johannesburg, Stamboll, Seul, Kubë, pa folur për aktivitetet ekspozuese në Kasselit e Munster. Bienalja e Venecias mbetet gjithsesi një ngjarje e rëndësishme, ku eksperienca të ndryshme takohen në nivel institucional, e ku mund të verifikohen "tendencat më të reja" artistike. Le të themi që akoma në ditë e sotme çdo dy vite e gjithë bota e artit mblidhet në këtë qytet të mrekullueshëm. "I Giardini", ku prezantohen zakonisht stendat kombëtare të Binales, edhe pika tjetër



kryesore "Arsenale" (e hapur që nga vitet '80) janë vendet kryesore të evenimentit. Përveç kësaj janë edhe disa vende jashtë këtyre të fundit, që mund të jenë prezencat të tjera kombëtare ose evenimente kolaterale zyrtare, që në këtë vit arrijnë numrin 44. Një nga këto evente është edhe "Krosing" (ku jam pjesëmarrëse me projektin tim më të fundit SENSATION SEEKERS), i cili zhvillohet në një vend të mrekullueshëm e domethënës për tematikën e idenë kuratoriale të zgjedhjes së artistëve. Në Forte Marghera, pikërisht në një zonë strategjike që krijon një urë lidhjeje midis Venecias e Mestres, midis tokës e lagunës, në transformim fizik nga një makinë ushtarake në hapësirë publike, me vlera të veçanta historike. Me kalimin e kohës, fortifikimet e Forte Margheres të ndërtaura duke u nisur nga vitet 1805 prej ushtrive austriake e franceze, kanë humbur vlerën e tyre në termin strategjik ushtarak, duke përvetësuar kështu një vlerë dëshmitare të së kaluarës. Një vend kufiri. Ishte pikërisht ky element që më magjeps për të zhvilluar projektin tim "Sensation Seekers", i realizuar posaçërisht për edicionin e 53-të të Binales së Venecias.

Këtë përballje me artistë nga e gjithë bota, si e shihni? Është kjo një rritje në krijimtarinë tuaj?

Sigurisht vetëm pjesëmarrja si vizitor shumë shpesh është stimulues dhe të ngarkon me energji e ide të reja. Aq më shumë pjesëmarrja personale të përfshin automatikisht në atë mekanizëm përvoja të vetme në llojin e saj. Për më tej, ashtu siç e nënvizova më lart, artisti ndien përgjegjësinë më të madhe për t'u përballuar kështu me publikun e shtypin ndërkombëtar.

Përveç vetes suaj, a e përfaqësoni edhe Shqipërinë aty?

Është momenti i duhur ku prezantimi personal shndërrohet edhe në

# VENERA KASTRATI

## Pavarësisht, në Biennale di Venezia

Shqipëria zyrtarisht nuk merr pjesë, por është e pranishme në evenimentin e rëndësishëm kulturor të hapur më 7 qershor me pjesëmarrjen e artistes shqiptare me banim në Milano krahas disa artistësh të tjerë shqiptarë.

Kastrati, Robert Aliaj Drago, Artan Shabani, Eliza Hoxha dhe Klodian Deda janë pjesë e projektit të pavarur "Crossing"



prezantim kombëtar. Kjo më bën të ndihem dyfish e ngarkuar me emociione dhe krenare që kam mundësinë të komunikoj me "botën" nëpërmjet artit tim.

**Përse keni zgjedhur të merrni pjesë me një video-instalacion?**

Është vetë projekti që më shtyu të përshkoja rrugën e kërkimit të një shprehjeje artistike multimediale. Në këtë video-instalacion ka rëndësi të madhe komunikimi nëpërmjet fotografisë, ritmikës, muzikës (kjo e fundit me shumë mjeshtëri e sensibilitet është realizuar posaçërisht për "Sensation Seekers" nga grupi rok milanez "Circo Fantasma", nga Nicola Cereda, këngëtar, kompozitori e figura qendrore e grupit).

Ideja është që publiku për një moment të harrojë prezencën hapësirë-kohë e të bëhet pjesë e elementeve të instalacionit. Kështu kompletion kuadrin e ngjarjes, që në realitet nuk ka një fillim e mbarim, por duhet të hapë vetëm mundësi reflektimi e diskutimi.

**Veprën me të cilën do të paraqiteni e keni titulluar "Sensation Seekers" dhe keni kërkuar të rrëmoni thellë në psikologjinë njerëzore. A mund t'i bëni një analizë veprës suaj?**

"Sensation Seekers", që në formën e saj letrare përkthehet në shqip "Kërkuesit e emocioneve ekstreme", lindi si një multivëzhgim i personave që praktikojnë sporte ekstreme dhe si analizë e projektimit psikologjik të dëshirës e nevojës së çdokujt për të kaluar çdo lloj kufiri, moral apo fizik. Video-instalacioni zhvillohet në tri projekte. Pjesa qendrore, ku edhe ideja merr formë, është e shkëputur nga një burim informacioni virtual e

Majtas, kopertina e "Shqiptari i Italisë" i majit 2008 që i kushtonte Kastratit një speciale. Lart sekuenca nga videoinstalacioni "Sensation seekers" me të cilin Kastrati paraqitet në "Crossing".




Venera Kastrati

**"Është momenti i duhur ku prezantimi personal shndërrohet edhe në prezantim kombëtar. Kjo më bën të ndihem dyfish e ngarkuar me emociione dhe krenare që kam mundësinë të komunikoj me "botën" nëpërmjet artit tim"**

real, të një ngjarjeje të kohëve të fundit në malet e Akoncaguas në Argentinë. Është një video e një grupi alpinistësh që praktikojnë këtë sport ekstrem dhe vdekja tragjike e udhëheqësit të tyre Federico Campanini. Në vend që të mendojnë për të shpëtuar jetën e guidës, i cili për çështje shëndetësore e vështirësi klimatike fillon të dorëzohet, alpinistët fokusohen në ndjekjen e objektivit të tyre, që në këtë rast zë vendin e parë. Ata duan të arrijnë me çdo kusht majën më të lartë të malit të Argentinës, Akoncaguas. Për më shumë alpinistët trajtojnë në mënyrë çnjerëzore

Udhëheqësin e grupit, duke e tërhequr me një litër prej qafe. Përdorin fraza fyese kundrejt tij dhe për më shumë dokumentojnë ngjarjen pjesërisht në video nëpërmjet një celulari. Grupi i alpinistëve shfaq shenja nervozizmi e paniku. Qëllimi i tyre i kalon kufijtë e çdo sensibiliteti njerëzor dhe videoja mbart në vetvete elemente që krijojnë indinjim të menjëhershëm. Arritja e një qëllimi, mënyrat për ta arritur dhe nevoja për të kërkuar këto emociione ekstreme janë tri elementet kyçe të projektit.

Dy videot e tjera që kompletojnë instalacionin janë pikërisht analizë e dy elementeve që bëjnë pjesë në natyrën njerëzore, duke filluar me kërkimin natyral të këtyre emocioneve ekstreme në fazën infantile nëpërmjet lojës (në këtë rast, lisharësja dhe rezultati i efektit të marramendjes), duke arritur kështu deri në personat që praktikojnë rite dhe eksperiencia fetare (në këtë rast vallja e dervishëve) për të krijuar marrëdhënie direkte me figurat hyjnore nëpërmjet marramendjes e humbjes ose jo të autokontrollit.



Që sot familja është më pranë teje

me ISI Sponsor dhe ISI Medical  
mund të sjellësh në Itali  
personat që do.

Policat e sigurimit ISI Sponsor dhe ISI Medical  
janë të domosdoshme për të gjithë ata që duan të hyjnë në Itali.

Për më shumë informacion, për të njohur dyqanet që shesin  
produktet ISI Insurance ose për të blerë  
drejtpërdrejt policat ISI Sponsor dhe ISI Medical  
vizito faqet internet ose telefono në call center.

Mund t'i gjesh vetëm në pikëshitjet më të mira 




[www.isiinsurance.it](http://www.isiinsurance.it)

tel: 06.3215205

Mesazh publicitar me qëllim promovimi. Për kushtet e kontratës mund të konsultohen fletët informuese të bashkëngjitura  
policës ose të vëna në dispozicion pranë pikave ISI Insurance ose në faqet internet [www.isiinsurance.it](http://www.isiinsurance.it).  
Drejtimi dhe Koordinimi Gruppo Arca Vita SpA

 Insurance

Kompania e Sigurimit e Qytetarëve të Rinj





Leonard Sherifi, është një piktor i ri shqiptar, me shumë ekspozita pas, i cili i shtohet listës së suksesshme të artistëve shqiptarë që shëtisin teknikave dhe konceptualizmit shumëformës së artit bashkëkohor. I lindur në Berat në 1982, Sherifi sapo është diplomuar në Akademinë e arteve të Genovas, ndërsa sapo ka përfunduar ekspozitën e tij më të fundit. Italia ka qenë për të një etapë emancipuese, formuese, e konsideruar si një stacion, por vetëm një prej të shumtëve në të cilët duhet të ngjizet psikja e artistit për të prodhuar art. Etapa e ardhshme është Çikagoja, prej nga artisti mendon të marrë shtysa të reja në një botë artistike, më pak hierarkike e më të lirë. Ndërsa Shqipëria, që pulson në nuancat e punëve të Sherifit, ngelet tani për tani një sfond i jetës së tij, dhe i së kaluarës, për arsye objektive e subjektive. Është një artisti i ri i sapoformuar, që eksperimenton me teknika dhe ide artistike të ndryshme, por duke u strehuar më besueshmëri tek piktura, mjete i parë i shprehjes që i është mësuar.

#### Si lindin punët tuaja?

Projektet e punëve të mija lindin zakonisht nga situa kalimtare dhe eksperiencia personale që i has në jetën e përditshme por përgjithsisht është një punë autobiografike në kuptimin e brendshëm, që lidhet ngushtë me prejardhjen time, janë të shumta situatat që më bëjnë të reflektoj dhe që nuk arrij t'i jap akoma një shpjegim por të cilat më prekin shumë dhe më lënë pa fjalë, dhe janë këto gjëra që përpiqem të pasqyroj në punën time duke kërkuar shpjegime me gjuhën e artit pamor.

#### Cilat teknika preferoni me shume?

Kryesisht unë përdor pikturën pasi e përvetësoj mirë si teknikë, pas shumë viteve eksperiencë, por nuk mbaron gjithçka me kaq sepse disa punë funksionojnë më mirë me video ose me fotografinë, disa të tjera me instalacione, prandaj nuk mund të them se përdor vetëm një medium.

#### Si keni filluar te merreni me art? Si mendoni çfarë ju ka dhënë Shqipëria në këtë drejtim?

Marrja me art me thënë të drejtën ka filluar këto 3-4 vitet e fundit. Më parë duke filluar nga liceu e deri në vitet e para të akademisë janë vetëm studime,



## LEONARD SHERIFI

# “Po të rri shumë gjatë, do të rri për fare”

titullohet jo rastësisht ekspozita e artistit të ri shqiptar i cili nga Shqipëria ka ardhur në Itali për t'u rritur profesionalisht, dhe rrugëtimin e tij e sheh drejt Amerikës.



ushtrime. Shqipëria në këtë drejtim më ka dhënë shumë mundësi dhe në një farë mënyre edhe vazhdon të më japë pasi shume punë të miat kanë lindur atje.

#### Perse keni ardhur te studioni ne Itali? Cfare mendoni se mund te gjeni me shume ne Itali?

Kam ardhur në Itali sepse mendoj se këtu je në kontakt të drejtpërdrejt me artin, dua të them që ekspozitat që shikon janë të gjitha epokave por jo vetëm, kjo por edhe mijëra e mijëra eksperiencia që të rastisin t'i përballosh, bëjnë shumë mirë për rritjen nga ana profesionale të një artisti. Mendoj se një artist duhet të udhëtojë dhe të lëvizë nëpër botë për t'i njohur gjërat nga afër dua të them se shumë situata në qoftë se nuk jetohej nuk filtrohen me të vërtet nga një artist, nga kjo pikëpamje unë kam dhe shumë e shumë rrugë për të bërë.

#### Mendoni te ktheheni ne Shqipëri pas studimeve? Ku e shikoni veten?

Këtë vit unë kam mbaruar studimet përfundimisht këtu ne Itali dhe jam duke u transferuar në Shtetet e Bashkuara, në Chicago për të studiuar akoma atje, dhe për të kërkuar të krijoj ndonjë kontakt pune me ndonjë galeri.

#### Ndërkohë mbani lidhje me Shqipërinë?

Me Shqipërinë nuk kam asnjë lloj kontakti dhe mendoj se atje po s'pate miq zor t'i bësh gjërat... Edhe në Itali, logjika është e njëjta si në Shqipëri...

Me kolegët e moshës sime në Shqipëri nuk kam asnjë lidhje.

#### E ndiqni artin bashkëkohor shqiptar? Çfarë mendoni për të? Vitet e fundit shumë artistë shqiptarë janë afirmuar në fushën e arteve pamore në nivel ndërkombëtar...

Për sa i përket artit bashkëkohor shqiptar, më bëhet qejfi që shumë artistë po afirmohen në nivel ndërkombëtar, po kthehem prapë tek pyetja më sipër për të thënë se këta artistë janë afirmuar jashtë territorit shqiptar dhe ja perse është e domosdoshme të dalësh nga Shqipëria dhe të jetosh në ndonjë vend evropian apo perëndimor, por mos të harrojmë se nuk mjafton vetëm kjo për tu bere tu afirmuar. Ndër artistët shqiptarë më pëlqen puna që bën Anri Sala, më duket shumë inteligjente....

#### Cilët janë artistët që preferoni më tepër?

Nga artistët që preferoj më tepër janë: Henri Matisse, Andy Warhol, Francis Bacon, Bill Viola, Matthew Barney, Olafur Eliasson.

(ma.ru)

**S**i u bëra i padukshëm" kësh-tu titullohet romani i gjinisë fantastiko-shkencore i shkruar nga ish-pedagogu i fizikës së Universitetit të Tiranës, Konstandin M. Leka. Një rikthim në letërsi i autorit, mbasi ky nuk është libri i parë i tij. Leksi i pasionuar shqiptar duhet ta kujtojë për novelën fantastiko-shkencore "Udhëtim në zemër të hydrocentralit" botuar vite më parë. Po ky roman, mund të quhet si dalje e re dhe me bujë, në skenën e letrave shqiptare, për dy arsye themelore: për gjininë fantastiko-shkencore, pak e lëvruar në letërsinë tonë, dhe për subjektin që paraqet.

Autori zgjodhi Tiranën për promovimin e këtij libri, vendin ku dhe subjekti i romanit të "njeriut të padukshëm" ka "lindjen" e tij. E solli atë mes miqve, dashamirësve e ish-studentëve të tij, të cilët kanë njohur e ndjekur pasionet e prof. Konstandinit. Janë pikërisht ata që më mirë se kushdo tjetër kanë kuptuar edhe pse në këtë krijimi. Në fakt, asnjëri prej tyre nuk u befusua për daljen e romanit, të gjithë ishin të bindur që pasionet e profesor Konstandinit një ditë do të gjenin rrugën e shprehjes. Selia e përzgjedhur për promovim në Tiranë ishte salla e Teatrit të Operas, e cila ftoi këtë eveniment ditën e 8 qershorit 2009.

Pamë jehonën e këtij promovimi në mediat shqiptare e në internet e në s'dëshëm të mungonim në takimin me autorin, aq më tepër që ai është një nga ne "shqiptarët e Italisë", që prej 17 vjetësh jeton në Trieste me familjen e tij. Iu drejtua për një njohje jo vetëm si autor i një veprë të re, por edhe si përfaqësues i një gjenerate, që përbën ndofta një të tretën e prezencave të shqiptarëve në Itali, nga e cila gjenerate kemi gjithnjë çfarë të mësojmë.

Zoti Konstandin pranoni të bëjmë një përshkrim të shkurtër të biografitë suaj për lexuesin: Cila është vendlindja juaj dhe ku keni kryer studimet dhe ku keni zhvilluar aktiviteti tuaj profesional në Shqipëri?

Në radhë të parë ju falenderoj për këtë intervistë, aq më tepër në rastin tim, që prej vitit 1973 megjithëse kam punuar, krijuar dhe punuar me shumë intensitet si në Universitet dhe në institucionet e tjera të Shqipërisë nuk përmendesha në masmedia, në fillim për arsye origjine dhe më vonë si harrësë e aktivitetit tim.

U lindi në Trieste të Italisë në të largët vit 1932, nga nënë italiane (triestine) dhe atë shqiptar nga Durrësi, për arsye se familja e atit tim kishte emigruar për arsye ekonomike në Trieste. Por, shumë shpejt u kthyem familjarisht në Durrës, ku fillova klasat e para të shkollës fillore. Pas mbarimit të gjimnazit mu dha e drejta e studimit në Institutin e Lartë Bujqësor, i cili sa ishte hapur. Duke pasur që në vogëli pasionin e aparaturave dhe i dalluar në degën e Fizikës, pranova të mos ndiqja Institutin Bujqësor, që ishte një botë krejt e

# KONSTANDIN LEKA

## "Si u bëra i padukshëm"



Prej vitesh në Trieste, Konstandin Leka rikthehet para lexuesit shqiptar e prezantohet për herë të parë para atij italian me romanin fantastiko-shkencor "Si u bëra i padukshëm"

huaj për mua dhe të pranoja Institutin Dvjeçar Matematikë-Fizikë, duke përfunduar pastaj Fakultetin e Shkencave të Natyrës, dega Fizikë me temën "Mbi rritjen artificiale të kristaleve".

Deri në vitin 1989 kam qenë profesor fizike e matematike, fillimisht në Politeknikumin "7 Nëntori" e më pas në Universitetin e Tiranës. Por aktivitetin tim më të madh e kam zhvilluar në drejtim të teknikave audiovizive duke ngritur dhe drejtuar Qendrën e Teknikës Audiovizive, që ishte e vetmja qendër që prodhonte në vend diapozitiva dhe kinofilma për mësimin dhe shkencën. Për këtë aktivitet u specializova jashtë shtetit, mbrojtja tema shkencore dhe u vlerësua me çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. Në vitin 1980 fitova çmimin e parë për ciklin me tregime shkencorë popullore "Niku Elektriku" në revistën "Fatosi" dhe po këtë vit kam botuar novelën fantastiko-shkencore "Udhëtim në zemër të hydrocentralit" për adoleshentë.

**Që kur shkenca dhe arti bashkëjetojnë si pasione te ju ?**

Kjo është një pyetje që më sjell kuj-

time që nga fëmijëria e hershme, kur në Trieste tek laboratorit i datës sim, për të parën herë u vura në kontakt me aparaturat dhe fenomene elektrike. Bileva menjëherë një aparat foto dhe një kinematografik, që nuk i ndava më nga dora për gjithë jetën time. Madje edhe tani vazhdoj të jetoj me to.

Gjithashtu prej kësaj moshe nuk mund në leximet e vazhdueshme të revistave për fëmijë dhe më vonë librave popullore shkencorë me tematika nga më fantastike dhe aventurore të shkencës.

Kurse pasionin për artin në përgjithësi dhe veçanërisht të muzikës klasike e kam të trashëguar nga nëna, që më vinte në gjumë me tregimin e subjekteve të operave dhe duke m'i kënduar ariet e tyre kryesore. Për herë të parë në një shfaqje opere kam qenë në Teatrin e Operës së Triestes në moshën gjashtë-shtatë vjeç.

Këto pasione u zhvilluan gjatë gjithë jetës sime duke u pasqyruar në të gjitha krijimtaritë, sidomos në programet Radiotelevizive dhe në konkurset shkencore, që i kam organizuar sipas një skenari spektakël me muzika të zgjedhura, këngëtarë dhe dramatizime me aktorë të njohur të kohës.

Po ju them një sekret se zakonisht subjekti që zgjidhja ishte i varur nga dëshira e përdorimit të ilustrimit muzikor special dhe efekteve teknike të veçanta. Në shumicën e dramatizimeve mund të gjeje akorde dhe sigla muzikore me efekt, që nuk transmetoheshin dhe zhurma rufesh dhe bubullimash, shpërthime nga të gjitha llojet me shumicë. Dikush më tha atëherë: "Të lumtë! Ti me këto programe po fiton shumë lekë!" Unë qesha dhe iu përgjigja shumë sinqerisht: "Jam gati të jap akoma më shumë lekë vetëm "të më lenë" të punoj si dua unë një studio."

**Studentët e Universitetit të Tiranës ju kujtojnë si një figurë të nderuar e rrezatuese e kulturës e edukatës qytetare. Por mbi të gjitha për një ekuilibër e finesë mbijetese në ambjentet "e mbyllura" e pa perspektivën e duhur për një studiu të apasionuar. Këtu e ka origjinën "i padukshmi"?**

Në vija të përgjithshme unë them se kini të drejtë, por le ta analizojmë më mirë. Është mjaft e vështirë për rininë e sotshme, që mund të shprehen dhe të shkruajnë çdo mendim për këto dhe për çdo ngjarje të kuptojë se në çfarë trysnie, çensurë dhe autoçensurë kemi jetuar dhe krijuar ne brezat e mëparshëm. Në rininë tonë p.sh. mjaftonte që një person të rridhte nga një familje e pasur, d.m.th. me prona

dhe toka edhe pa i bërë keq askujt konsiderohej njeri i dëmshëm dhe i rrezikshëm për shoqërinë. Kështu dhe unë duke qenë me origjinë tregtare e pasur nga im atë, vetëm duke kaluar nga Durrësi në Tiranë, ku nuk ishim të njohur dhe duke u regjistruar si tregtar me origjinë të mesme, pothuaj se shpëtuan konsekuencat që nuk do të më lejonin të bëja shkollën e lartë. Por, gjatë gjithë aktiviteteve të përmendura më lart, megjithëse të vlerësuara nga institucionet përkatëse unë jetoja me frikën, se në çdo moment do të "zbulohet" origjina dhe do t'i humbja të gjitha. Sigurisht vetëm se isha me origjinën e një tregtari të mesëm dhe me nënë italiane, unë as që përmendesha në masmedia për gjithë këto aktivitete. Kisha vetëm ndonjë vlerësim me zë të ulët, "në vesh", një shtrengim dore dhe të shumtën një buzëqeshje. Megjithatë unë i përballoja këto qëndrime, se kisha kënaqësinë e krijimit dhe të paktën arrija të realizoja disa nga pasionet e mia. Mua më rëndonte në shpirt dhe zhgënjimi që kishte pësuar im atë, që megjithëse kishte ndihmuar moralisht dhe financiarisht Lëvizjen Antifashiste, përsëri pësoi herë pas herë persekutime të rënda, përveçse iu grabit gjithë pasuria. Sigurisht tani në distancë vitesh, kur persekutimet vetëm kujtohen, mund të arrihet në disa konkluzione të përgjithshme. Unë ndjeva si një kërkesë të brendshme të ringjalljes në këtë mjedis ku isha i harruar, pra isha "i padukshëm". Por ringjalljen do ta bëja me "mjetet" e mia duke vënë në dukje tiparet kryesore të veprimtarisë sime. Për këtë si tematikë më të përshtshme zgjodha fenomenin e padukshmërisë.

**Nga diskutuesit në promovimin e librit në Tiranë theksohet një karakteristikë fundamentale e romanit: subjekti i qartë. Ishte kjo një përzgjedhje teknike apo e sugjeruar nga vetë ecuria e shkrimit të romanit ?**


Qartësia e zhvillimit të romanit varet nga fakti i thjeshtë, se linja bazë mbështetet në një ngjarje reale, atë të rritjes artificiale të kristaleve, po ashtu siç e kam realizuar në laboratorin e fizikës për mbrojtjen e temës. Të gjitha aparaturat, veprimet dhe fenomenet që ndodhin vetëm me përjashtim të "arritjeve" fantastike, sidomos nga fundi i romanit janë reale, se i kam jetuar vetë. Kjo është dhe një zgjedhje e imja e qëllshme për të lidhur realitetin e laboratorëve dhe punës shkencore në vendin tonë me shkencën botërore, pa përdorur linja të shpërthimeve fantastike, magjike, dhe sureale, që gjejnë në krijimtarinë e sotshme të fantastiko-shkencore.

Albana Temali



Identiteti dhe kulturat e një kryeqyteti multi etnik

# Tregoni historinë tuaj



Dërgo fotografi, video dhe mesazhe zanore tek

# [www.migrart.it](http://www.migrart.it)



contrasto



Kush është person me aftësi të kufizuara

Person me aftësi të kufizuara është ai që paraqet një mangësi fizike, psikike apo shqisore, të stabilizuar ose progresive, për shkak të së cilës ka vështirësi në të kuptuar, në marrëdhënie apo në integrimin në punë dhe si e tillë aftësia e kufizuar i përcakton një proces disavantazhi shoqëror ose emargjinimi. Personi me aftësi të kufizuara ka të drejtën e shërbesave të përcaktuara në favor të tij sipas natyrës dhe cilësisë së gjymtimit, sipas aftësisë totale individuale që i mbetet dhe sipas efikasitetit të terapive rehabilituese. Për të vendosur shkallën e aftësisë së kufizuar i interesuari duhet t'i drejtohet komisioneve të posaçme mjekësore që veprojnë në njësitë shëndetësore vendore (USL).

Të mirat e parashikuara nga ligji 104/92

Qëllimi i ligjit 104/92 është kapërcimi i pengesave që dalin mes shoqërisë dhe personave me aftësi të kufizuara dhe një integrim më i mirë i tyre duke vepruar në mënyrën më specifike të mundshme, me synim futjen sa më të plotë të personit me aftësi të kufizuara në kontekstin shoqëror. Një pjesë e të mirave mund të përfitohen nga të gjithë personat me aftësi të kufizuara ndërsa një pjesë tjetër u njihen në bazë të shkallës së aftësisë së kufizuar. Në të vërtetë disa të mira parashikohen nga dispozita të tjera ligjore, por që gjithnjë varen nga njohja e personit me aftësi të kufizuar. Të mirat që mund të përfitohen nga ligji 104 janë të mëposhtmet.

Leje për punonjësit, lehtësime për prindërit

Ja përfitimet për ata që arrijnë të përfitojnë nga ligji Punonjësi apo punonjësjë që ka të birin me aftësi të kufizuar të shkallës së lartë apo që përkujdeset për një familjar apo të afërt (me lidhje farefisnore deri në gradën e tretë) me aftësi të kufizuar të shkallës së lartë, apo punonjësi ose

## LIGJI 104/1992

**Ligji 104/1992, "Ligji kuadër për asistencën, integrimin social dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara", ashtu siç e thotë në emërtim, trajton çështjet e asistencës, të integritit shoqëror, dhe të të drejtave të personave që kanë aftësi të kufizuara dhe parashikon njohtjen e disa të lehtësimeve për punonjësit të tillë dhe familjarët që përkujdesen për ta**

punonjësjë me aftësi të kufizuara të shkallës së artë, ka të drejtë:

1. të mos transferohet me punë nga një seli në një tjetër pa pëlqimin e tij/saj;
2. të zgjedhë selinë e punës më të afërt me vendbanimin e vet apo të personit për të cilin kujdeset.

Punonjësit me patologji onkologjike dhe me aftësi të reduktuar pune për shkak të terapive që u shpëtojnë jetën, kanë mundësinë të transformojnë marrëdhënien e punës nga një marrëdhënie me kohë të plotë në marrëdhënie pune me kohë të pjesshme, të ashtuquajtur part-time, (horizontalisht ose vertikalisht: pra të zgjedhin të punojnë më pak orë në ditë apo më pak ditë në javë). Kjo mundësi u jepet të gjithë punonjësjëve, të sektorit shtetëror e privat

E njëjta e drejtë përparësie për transformimin e marrëdhënies së punës në part-time u jepet edhe punonjësjëve, burra ose gra, që kujdesen për familjarë apo persona me të cilët bashkëjetojnë, në rast se:

1. patologjia onkologjike prek bashkëshortin/en, një nga bijtë apo një nga prindërit e tyre;
2. përkujdesja i ofrohet një personi bashkëjetues me punonjësin, person të cilit për shkak të të qenit krejtësisht i paafte për punë, i njihet në të njëjtën kohë:
  - 100% invaliditet;
  - aftësi e kufizuar e shkallës së lartë
  - e drejta e kompensimit për shoqërim pasi nuk është i aftë të

kryejë veprimet e jetës së përditshme.

Lejet pas vitit të tretë e deri në vitin e tetëmbëdhjetë të jetës së birit me aftësi të kufizuara

Prindërit, o njëri o tjetri, kanë të drejtën që të largohen nga puna tri ditë në muaj pa iu ndaluar rroga. Prindit që e kërkon i takon të marrë tri ditë leje nga puna edhe nëse tjetrit nuk i takon apo nëse në familje ka persona të tjerë që mund të ofrojnë kujdesin e tyre ndaj personit me aftësi të kufizuara. Prindërit mund të përfitojnë nga kjo leje edhe nëse fëmija është i adoptuar apo u është besuar përkohësisht.

Tri ditë e lejes mund të ndahen mes prindërve edhe me shkëputje të njëkohshme nga puna. Tri ditë e lejes mujore mund të ndahen në orë në mënyrë që t'i mundësohet punonjësit apo punonjësjës që i merr, një orar elastik pune. Është gjithashtu e mundur që në të njëjtën kohë një prind të përfitojë nga shkëputja nga puna për arsye familjare (kur fëmija është deri në 8 vjeç) ndërsa prindi tjetër të përfitojë lejen mujore për aftësi të kufizuar të familjarit.

Lejet për bijtë në moshë madhore

Prindërit (natyrorë, adoptues apo në besim) të bijve në moshë madhore kanë të drejtën alternative për tri ditë leje të paguar në muaj, edhe të njëpasnjëshme. Tri ditë e lejes mund të ndahen mes prindërve edhe shkëputje të njëkohshme nga



puna. Tri ditë e lejes mund të fraksionohen në orë. Në rast se biri jo i vetëmjaftueshëm bashkëjeton me prindërit, e drejta e tri ditëve të lejes për prindin që punon nuk varet aspak nga fakti nëse tjetri është në marrëdhënie pune apo jo dhe as nga fakti që në familje mund të jetë dikush tjetër që mund t'i ofrojë asistencë.

Në rast se i biri nuk bashkëjeton me prindërit, e drejta e tri ditëve leje në muaj varet nga kushti i vazhdueshmërisë dhe ekskluzivitetit të asistencës dhe nga mungesa e pranisë, në bërthamën familjare të personit me aftësi të kufizuara, të personave të tjerë jo në marrëdhënie pune (përfshirë prindin tjetër) të aftë për t'i ofruar asistencë.

Leje për t'u kujdesur për një familjar apo të afërm deri në shkallë të tretë

Punonjësi/ja që përkujdesen për një familjar apo të afërm me lidhje farefisnore deri në shkallë të tretë, përfshirë edhe bashkëshortin, kanë të drejtën e tri ditëve leje të paguar në muaj. Edhe kjo mund të ndahet në leje disaorëshe. Nuk është kusht i domosdoshëm bashkëjetesa me personin me aftësitë e kufizuara por përkujdesja duhet të jetë e vazhdueshme ose me karakter sistematik dhe të përshtatshëm.

Norma të tjera legjislativë kanë zgjeruar mundësinë e përfitimit të kësaj të drejte, ndaj edhe:

- prania e familjarëve të tjerë jo në marrëdhënie pune, në bërthamën familjare të personit me aftësi të kufizuara, nuk pengon punonjësin të përfitojë nga lejet mujore me të drjtë rroge;
- personi me aftësi të kufizuara, tutori ligjor ose administratori mbështetës i tij ka të drejtë të zgjedhë brenda familjes së vet se cili duhet t'i ofrojë asistencë duke përfituar lejet e ligjit 104/92;
- e drejta e lejeve u njihet edhe atij që, edhe pse punon e jeton larg vendbanimit të personit me aftësi të kufizuara, i ofron asistencë të vazhdueshme pasi është sistem-

**IL SANGUE LANGUE**

la donazione del sangue ha bisogno di una svolta

facciamone anche quattro

**rimbocchiamoci le maniche**

www.sanguelangue.it 800-012283

atike dhe e përshtatshme me nevojat e familjarit jo të vetëm-jaftueshëm. Në këto raste është e nevojshme të tregohet "Programi i asistencës" (me firmë të për-bashkët) që tregon mënyrën dhe synimin e përkujdesjes.

- prania e një ndihmëse familjare (badante, personel i shoqatave jofitimprurëse apo i strukturave publike) është e pajtueshme me përfitimin e lehtësimeve në punë nga anë e familjarëve që i kërkojnë ato.

Me shtrim në spital (pengues për përfitimin e lehtësimeve në punë) duhet kuptuar që personi me aftësi të kufizuara të shkallës së lartë është i shtruar në spital për 24 orë në ditë (pra jo në day-hospital) Megjithatë nëse personi i shtruar është në gjendje kome dhe/ose në fazë terminale, familjari ka të drejtë të përfitojë nga lehtësimet në punë.

**Procedura**

Procedura që duhet ndjekur për të kërkuar lejet e parashikuara si lehtësime në punë për asistencë ndaj një familjari me aftësi të kufizuara apo për veten.

a) punonjësi që paraqet kërkesën e përpilon atë në një formular të

gatshëm të INPS-it, i bashkëngjit certifikatën mjekësore të personit me aftësi të kufizuara që dëshmon "aftësinë e kufizuar në gjendje të rëndë" dhe informacione të tjera që dëshmojnë përmbushjen e kushteve të kërkuara nga norma;

b) punonjësi kërkuar i paraqet kërkesën INPS-it që e merr në shqyrtim. Në fakt, INPS-i verifikon përmbushjen e të gjitha kushteve të kërkuara nga ligji për përfitimin e lehtësimeve në punë;

c) në përfundim INPS-i i dërgon punonjësit, punëdhënësit dhe Patronatit vendimin e njohjes apo të mohimit të lejeve. Me këtë vendim certifikatë përmbushjen e të gjitha kushteve shëndetësore dhe administrative të kërkuara dhe gatishmërinë për rimbursimin e këtyre lejeve;

d) punonjësi i komunikon punëdhënësit mënyrat se si dëshiron të përfitojë lejet apo shkëputjet nga puna për person me aftësi të kufizuara.

**Lejet për punonjësin me aftësi të kufizuara**

Punonjësi me aftësi të kufizuara të shkallës së lartë ka të drejtë:

- për tri ditë leje në muaj të paguar  
 - ose për dy orë leje në ditë nëse

orari i punës është mbi gjashtë orë në ditë, oes për një orë nëse orari ditor është maksimumi gjashtë orë.

Tri ditët e lejes mujore mund të përfitohen edhe si gjashtë gjysmë-ditë punë ose të ndara në leje me orë.

**Ç'duhet bërë që të të njihet statusi i "personit me aftësi të kufizuara"**

Për t'u njohur si person me aftësi të kufizuara në bazë të ligjit 104/92, i interesuari duhet t'i nënshtrohet vizitës mjekësore pranë komisionit të përzier të njësisë shëndetësore vendore, USL, ku bashkë me mjekët e specializuar sipas rasti të sëmundjes, janë të pranishëm edhe figura të tjera profesionale si psikologë/psikiatër, asistentë socialë. Parashikohet edhe mundësia e vizitave në vendbanim për ata persona për të cilët dokumentohet pamundësia e zhvendosjes. Për vizitat pranë vendbanimit i bëhet kërkesë Sekretarisë së Komisionit për invalidët civilë duke i paraqitur një certifikatë mjekësore që të dëshmojë paaftësinë absolute të personit. Për të marrë takim për vizitën i interesuari i drejtohet një

patronati apo qendrës së preno-timeve, me certifikatë mjekësore të mjekut të familjes ose të mjekut specialist për patologjinë e deklaruar.

Rezultatet e vizitës përbëjnë një dokument (kopje e vetme ndaj për Çdo përdorim duhet përdorur fotokopje) që shpreh vendimin e komisionit mbi rastin e shqyrtuar. Ky vendim i dërgohet më pas Komisionit Mjekësor Periferik për një miratim të mëtejshëm.

Komisioni Mjekësor Periferik mund të shprehë:

Vendim pozitiv (parere favorevole) - kur vendimi i tij përputhet me atë të komisionit të ASL-it. Në këtë rast rrugëtimi i praktikës përfundon në favor të të interesuarit.

Vendim të mospajtueshëm (parere discorde) - kur vendimi nuk përputhet me atë të komisionit të ASL-it. Në këtë rast mund të fiksojë një datë të re për një vizitë kontrolli.

Në të dyja rastet e mësipërme personit me aftësi të kufizuara i komunikohet verbali i vendimit duke ia dërguar në adresë të shtëpisë me postë të porositur me lajmërim marrjeje (raccomandata A.R.).

Stefano Camilloni



**Një tezgë në treg për Johnin**

Të marrësh iniciativën, të projektosh një sipërmarrje mund të mbetet vetëm një ëndërr nëse nuk keni mundësi të merrni një hua. Tani të hapësh një dyqan, të blesh mjetet, apo një furgon mund të bëhet nga kushdo që merr iniciativën të investojë, falë shërbimeve të mikrokredive të PerMicro.

John-it, 33 vjeç, kenian, në Itali prej 3 vjetësh në kërkim të një jete të re i erdhi një ide e mirë, por nuk kishte të ardhura të rregullta dhe mbi të gjitha nuk kishte një garanci. Filloi të punonte në një fabrikë për pak kohë dhe filloi të kryente punët të përkohshme në një kooperativë. Por puna ishte e paktë dhe kontratat ishin gjithmonë prej një apo dy muajsh, dhe nuk i lejonin të vinte mënjatë paratë për një shtëpi. "Doja të nisja një aktivitet të vogël duke shitur në treg, gjerdane, pareo, veshje të importuara nga Kenia dhe kisha nevojë për një hua për të blerë licencën, të hapja Partita Iva dhe të blija një furgon dhe pak mall. Nga disa miq mora vesh risinë e PerMicro, telefonova dhe më lanë takimin e parë", tregon John. Në fakt PerMicro ka nisur veprimtarinë në fund të vitit

2007 dhe sot është operatori i parë italian që jep vetëm mikrokredit ose *social lending*, veprimtaria e të cilit frymëzohet nga Grameen Bank e themeluar nga Muhammad Yunus, çmim Nobel për paqen në 2006.

Aktiviteti i tij nuk kufizohet vetëm me dhënie e një huaje por njerëzit që i drejtohen PerMicro, marrin edhe mbështetje dhe konsulentë nga ana e operatorëve që ndjekin sipërmarrësit e vegjël në të gjitha fazat e rrugës së tyre, duke iu ndenjur pranë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së financimit të tyre.

John fillon kështu bisedimet, ideja e tij verifikohet dhe pjesërisht modifikohet, PerMicro e ndihmon edhe në gjetjen e një furgoni më të përshtatshëm dhe bëhen e ribëhen llogaritjet për të vlerësuar më së miri aktivitetin që dëshiron të ndërmarrë.

Pas pak më shumë se dy javësh vjen edhe drita jeshile: John merr huan dhe mund të fillojë aktivitetin.

Sot shkuam ta takonim në tezgën e tij në treg ku na priti me buzëqeshje, duke na treguar projektet e tij për të ardhmen, dhe për shtëpinë që arriti të marrë me qira.



**për...  
të punuar  
më vete**



**për...  
të çuar  
në shkollë  
famijët**



**për...  
të rritur  
aktivitetin  
tim**



**për... idenë  
time të re**



**Deri më 15.000 euro**  
për ty, për mundësi të mëdha.


Për të nisur apo për të rritur aktivitetin tënd, për të mbajtur familjen larg, për t'u dhënë një të ardhme fëmijëve të tu:  
**011 658.778 - info@permicro.it**  
[www.permicro.it](http://www.permicro.it)







PerMicro është shoqëria e parë italiane e specializuar në dhënie e mikrokredive në të gjithë territorin kombëtar. Aktiviteti i Per Micro frymëzohet nga ai i Grameen Bank e themeluar nga Muhammad Yunus, çmim Nobel për paqen në vitin 2006.  
 PerMicro è autorizzata all'esercizio dell'attività finanziaria ai sensi dell'art. 106 - n. di iscr. 41437.




## HORIZONTALISHT

2. Kapiteni James, lundëtar e eksplorator anglez. 6. Grup Poetësh. 8. Kopsa pa ekstreme. 11. Në krye të garës. 13. Një kalë mitologjik. 16. Inicialet e Reitman, regjisor. 17. Artikull i gjermanishtes. 18. Role pa zanore. 19. Lidhet në qafë. 20. Një mundje japoneze. 23. West, aktore. 24. Formuan një Junta Santa Revolucionare. 25. Quan veten eskimezi. 26. Qytet spanjoll. 27. Në hyrje të oazit. 29. Ndërmarrje Autonome Greke. 31. Herë herë të zë edhe në traget. 32. Një kartë e fortë në bridge. 34. Qëllon; ndodh. 37. Wilhelm i harkut dhe mollës. 39. Muza e historisë. 41. Perëndia egjiptiane e diellit. 42. Jo kocka. 43. Sundonte në Venecia. 45. Ofiçina Automjeteve të Ndërtimit. 46. Dy të martuar formojnë një. 48. Aktori i *Tony Manero*-s (inic). 49. Inicialet e Tesla-s. 50. Nick, aktor amerikan.

## VERTIKALISHT

1. Djali i Parzival-it dhe opera e Wagnerit. 2. Joan, aktore tek Dynasty. 3. Sigël për Repartin e Otorinologjisë. 4. Përemër i serbo-kroatishtes. 5. Krim pa çifte. 6. Eshtë vajza e bandës. 7. I dha zjarrin njerëzimit. 8. Sipas mitologjisë skandinave ishte më i madhi i perëndive. 9. Mariana e Garcia Lorca-s. 10. Georges, piktor francez i "Cirku-t". 11. Një gaz i rrezikshëm në miniera. 12. I famshmi Pacino. 14. Profeti që u sharrua më dysh. 15. Poseidon. 21. Bartolome Esteban, piktori i Kuzhina e ëngjëjve. 22. Një sigël që tremb boksierët. 28. Një sportist në pistë. 29. Ishte patriark i Moskës. 30. Edith, këngëtare. 33. Yoko e John Lennon-it. 35. Qendër në kaos. 36. Një treshe në skenë. 38. Atje, për një italian. 40. Pak latinisht. 44. Një send. 47. Nota e parë.

HORIZONTALISHT: 1. LOHENGRIN. 2. VERTIKALISHT: 1. LONON. 2. GIGOLLO. 3. ORLANDO. 4. ONI. 5. KIL. 6. GIGOLLO. 7. YOKO. 8. JOHN LENNON. 9. EDITH. 10. MOSKA. 11. GAZI I RREZIKSHËM. 12. PACINO. 13. KALË MITOLOGJIK. 14. PROFETI QË U SHARRUA MË DYSH. 15. POSEIDON. 16. INICIALET E REITMAN. 17. ARTIKULL I GJERMANISHTES. 18. ROLE PA ZANORE. 19. LIDHET NË QAFË. 20. NËNDEJE JAPONEZE. 21. BARTOLOME ESTEBAN. 22. NËNDEJE JAPONEZE. 23. WEST. 24. JUNTA SANTA REVOLUCIONARE. 25. QUAN VETEN. 26. QYTET SPANJOLL. 27. NËNDEJE JAPONEZE. 28. NËNDEJE JAPONEZE. 29. NËNDEJE JAPONEZE. 30. EDITH. 31. HERË HERË TË ZË EDHE NË TRAGET. 32. NËNDEJE JAPONEZE. 33. YOKO. 34. QËLLON. 35. QËLLON. 36. QËLLON. 37. WILHELM I HARKUT DHE MOLLËS. 38. ATJE. 39. MUZA E HISTORISË. 40. PAK LATINISHT. 41. PERËNDIA EGJIPTIANE E DIELIT. 42. JO KOCKA. 43. SUNDONTE NË VENECIA. 44. NËNDEJE JAPONEZE. 45. OFIÇINA AUTOMJETEVE TË NËNDEJE JAPONEZE. 46. DY TË MARTUAR FORMOJNË NËNDEJE JAPONEZE. 47. NOTA E PARË. 48. TONY MANERO. 49. INICIALET E TESLA-S. 50. NICK.



## HORIZONTALISHT

1. Utrillo, piktor (inic). 3. Inspektori i Horst Tappert-it. 7. Lee Curtis, aktore. 13. Në hyrje të sallës. 15. Emri i parë i Fassbinder-it. 17. Film i Guillermo del Toro. 20. Një numër tek për femrat. 22. Një mund të jetë veprimi. 23. Dy asa në dorë. 24. Kështu janë letrat enciklike. 29. Pak teveqel. 30. Aktorja e "Ylli i Jugut". 32. Kalimi në ekstreme. 33. Dior i modës. 35. Roberts, aktor. 36. Një sigël e ndjeshmërisë së filmit. 37. Fundi i një cowboy. 38. Eshtë qedër. 39. Në radhë të parë. 40. Në krye të trupave. 41. King Cole i muzikës. 42. Eshtë i shtatë me kinemanë. 45. *Baby* në një film të Elia Kazanit. 47. Aktori i "Legjenda e pianistit mbi oqean". 49. Një raketë europiane. 51. Dyshi romak. 52. Zanoret e një peme. 53. Film i Lars von Trier-it. 54. Një dru i fortë.

## VERTIKALISHT

2. U tradhëtua nga Betsabea. 3. Pax i Zana Turkut. 4. Inicialet e Duvall, aktor. 5. Fise pa fe. 6. Komisari i Michele Placidos. 8. Fillojnë një argument. 9. Enzo, mesfushor italian. 10. Institucion Informativ Rajonal. 11. Janë për t'u mbushur. 12. Një mund të famshëm dylli. 14. Oscar i Portreti i Dorian Gray-t. 16. Një profet biblik. 17. Kukulla simbol e një kompeticioni. 18. Antonio, fantazist brez në Spanjë. 19. U vra nga Davidi. 21. Rosalino Cellamare në CD. 25. Janë duart e ariut. 26. Lumë në Gjermani. 27. Birrë pa kufij. 28. Një garë çiklistike japoneze. 30. Qyteti i Abrahamit. 31. Ortolani, kompozitor. 34. Virgjëresha të parajsës islamike. 42. Markë makine. 43. Një mund të jetë fetar. 44. Janë të ndryshme në trarë. 46. Qan te Turandot. 48. Rita pa zanore. 49. Fundi i një samurai. 50. Alieni i Steven Spielbergut.

HORIZONTALISHT: 1. UTRILLO. 3. HORST TAPPERT. 7. LEE CURTIS. 13. NËNDEJE JAPONEZE. 15. FASSBINDER. 17. GUILLERMO DEL TORO. 20. NËNDEJE JAPONEZE. 22. NËNDEJE JAPONEZE. 23. DËNDEJE JAPONEZE. 24. KËNDEJE JAPONEZE. 29. PAK TEVEQEL. 30. AKTORJA E "YLLI I JUGUT". 32. KALIMI NË EKSTREME. 33. DIOR. 35. ROBERTS. 36. NËNDEJE JAPONEZE. 37. FUNDI I NËNDEJE JAPONEZE. 38. QEDËR. 39. NËNDEJE JAPONEZE. 40. NËNDEJE JAPONEZE. 41. KING COLE. 42. ESHTË I SHTATË ME KINEMANË. 45. BABY. 47. AKTORI I "LEGJENDA E PIANISTIT MBI OQEAN". 49. NËNDEJE JAPONEZE. 51. DËNDEJE JAPONEZE. 52. ZANORËT E NËNDEJE JAPONEZE. 53. LARS VON TRIER. 54. NËNDEJE JAPONEZE.



**www.stranieriinitalia.it**

**Faqet internet të emigracionit**

Çdo ditë lajme, hulumtime dhe informacione të dobishme për të gjithë të huajt në Itali.

Stranieri in Italia



**Dashi (21 mars - 20 prill)**

Puna: keni ëndrra, objektiva të rinj dhe shihni plot optimizëm të ardhmen. Dashuria: jeta mundane do t'ju mërzhitë nëse nuk sjell ndonjë takim ku të hyjnë në lojë ndjenjat tuaja. Shëndeti: dieta po fillon të japë rezultat. Ndoshta për në gusht do të jeni në formë të shkëlqyer.



**Demi (21 prill - 20 maj)**

Puna: projektet tuaja po shkojnë përpara edhe fal ndihmës së bashkëpunëtorëve. Dashuria: takime të rëndësishme për ata që janë single. Për të çiftëzuarit, pasioni do të rindizet. Shëndeti: me ekuilibër mes vetëkontrollit dhe trasgresionit gjithçka do të vejë mirë.



**Binjakët (21 maj - 21 qershor)**

Puna: nuk i keni hyrë siç duhet por megjithatë do të merrni një shpërblim ekonomik të papritur. Dashuria: bjerini pas personit që doni t'i merrni zemrën pa patur frikë mos dukeni qesharakë. Shëndeti: gjithçka nën kontroll, jeni më të qetë se zakonisht.



**Gaforrja (22 qershor - 22 korrik)**

Puna: edhe pse nuk jeni të kënaqur nga mjedisi i punës, do të arrini rezultate të shkëlqyera. Dashuria: do të njihni një person shumë tërheqës, kujdes mos bini brenda, nuk bën për ju. Shëndeti: ç'ju shqetëson është diçka estetike që vini re vetëm ju, ndoshta ju mjafton pak krem.



**Luani (23 korrik - 23 gusht)**

Puna: të nxirrni shefin tuaj për darkë dhe të mos ju mjaftojnë paratë për restorantin sigurisht që nuk ju ndihmon në karrierë. Dashuria: marrëdhënia është e re por ju dëshironi ta konsolidoni përditë e më shumë. Shëndeti: nxitimi dhe tensioni do t'ju sjellin edhe probleme me stomakun, jini më të qetë.



**Virgjëresha (24 gusht - 22 shtator)**

Puna: me mbështetjen e pakushtëzuar të eprorëve mund të bëni si t'ju dojë qejfi. Dashuria: doni të fitoni zemrën e dikujt që ju pëlqen por jeni të hutuar e nuk dini ç'të bëni. Shëndeti: humbisni e merrni peshë me shpejtësi, ndoshta duhet të ndërroni dietë.



**Peshorja (23 shtator - 22 tetor)**

Puna: shefit i duket gjithçka e lehtë ndaj nuk arrin të kuptojë vështirësitë që hasni. Dashuria: mos gënjehni veten, një shikim i ëmbël prej atij që ju pëlqen nuk është "po". Shëndeti: mjeku do t'ju ndihmojë të shëroheni shpejt nga një sëmundje e papritur.



**Akrepi (23 tetor - 22 nëntor)**

Puna: shefi është i gatshëm për ndryshimet që i keni kërkuar, ndaj tani nuk keni më justifikime. Dashuria: ndjenjat tuaja nuk janë të qarta, megjithatë do të ruani marrëdhënien pa e dhënë veten. Shëndeti: mjafton pakgjë për t'u sëmurur, ruhuni nga ajri i kondicionuar.



**Shigjetari (23 nëntor - 21 dhjetor)**

Puna: bëni gjera shumë interesante, por jo të gjithë arrijnë ta kuptojnë. Dashuria: i kushtoheni më shumë kërkimit të mirëqënies materiale se asaj shpirtërore. Bëni mirë të ndryshoni qëndrim sa më shpejt. Shëndeti: jeni në formë të shkëlqyer, nuk keni nevojë të mbani asnjë lloj diete.



**Bricjapi (22 dhjetor - 20 janar)**

Puna: jeni tepër të ngarkuar por kolegët ju vijnë në ndihmë duke marrë përsipër t'ju heqin punët më të mërzhitshmet. Dashuria: partneri vlerëson pak vëmendjen që tregoni ndaj tij. Shëndeti: me pak ushtrime fizike do të ndjeheni shumë më të zhdërvjellët.



**Ujori (21 janar - 19 shkurt)**

Puna: eprorët mundohen t'ju futin në sherr, por kaq nuk mjafton për të prishur miqësinë mes kolegësh. Dashuria: pushimet po afrohen, tashmë duhet ta keni vendosur ku do të shkoni t'i kaloni ato. Shëndeti: nuk dini të administroni energjitë tuaja, tani jeni krejtësisht pa forca.



**Peshqit (20 shkurt - 20 mars)**

Puna: më në fund me kolegët i jeni futur një projekti ku mund të shprehni aftësitë profesionale. Dashuria: shpesh bini në dashuri që me shikim të parë, jini më të kujdesshëm në zgjedhjen e partnerit. Shëndeti: jo gjithçka që ju pëlqen bën edhe mirë. Hani në mënyrë të ekuilibruar.

# CATWALK

IL NEGOZIO DI ALTA MODA A TIRANA

Ermenegildo Zegna

CESARE PACIOTTI

GIANFRANCO FERRE

CERRUTI 1881



ONI PUSTINA

RRUGA MYSLYM SHYRI, TIRANA

a mund të dërgoj para  
në **shqipëri** me

**7€\*** komision?



tani edhe nga **toskana**

shuma	komision*
€0,01 - €100	€7,00
€100,01 - €200	€10,00
€200,01 - €300	€13,50
€300,01 - €400	€17,00

shuma	komision*
€400,01 - €600	€26,00
€600,01 - €800	€34,00
€800,01 - €1.000	€44,50

oferta është e vlefshme nga 24 marsi 2009 në të gjitha agjencitë western union në lombardi, emilia romagna, piemonte, liguria, valle d'aosta, trentino alto adige, veneto, friuli venezia giulia dhe toskanë.

\* fondet në përgjithësi janë të disponueshme në pak minuta në varësi të afateve dhe kushteve të shërbimit, duke përfshirë dhe oraret e agjencive si dhe ndryshimet në çren lokale. për më tepër shikoni formularin e dërgesës për kufizimet. \*\* përveç komisionit, western union përfiton para shtesë kur këmben paratë tuaja në monedhen vendase. Komisionet standarte fillojnë me 1000.01 euro të dërguara në një transaksion. Për listën standarte të komisioneve ju lutemi, vizitoni agjencitë tona.

**WESTERN UNION** | **yes!**

familja juaj mund t'ju ndiejë pranë me një transfertë parash, kudo që ju mund të ndodheni.

+355 42 23 49 79

transfertë parash

gettare negli appositi cestini per proteggere l'ambiente.

www.wu.it

© 2009 WESTERN UNION HOLDINGS, INC. All rights reserved.